

MONITORIMI DHE RAPORTIMI MBI POLITIKAT  
RINORE NË NIVEL QENDROR- LIGJI 75/2019  
'PËR RININË' DHE POLITIKAT/STRUKTURAT  
NË ZBATIM TË TIJ 2023



Autorë: Dafina Peci  
Shila Parllaku

©2023 Kongresi Rinor Kombëtar

Address: Bulevardi Zogu i Pare, Rr. Papa Kristo Negovani Pall. Li-Em, Shkalla 1, Kati 2, Tirana 1040, Albania

Email: [info@krk.al](mailto:info@krk.al)

*Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer. Opinione, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet, shumëfishohet dhe shpërndahet duke përdorur sistemet elektronike, pa lejen me shkrim të Kongresit Rinor Kombëtar dhe Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer, përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit. Përdorimi komercial i këtij publikimi nuk është i lejuar.*

# TABLE OF CONTENTS

LISTA E SHKURTIMEVE .....	4
PARATHENIE .....	5
METODOLOGJIA.....	6
1. KAPITULLI: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PER RININE.....	8
1.1.  MINISTRI I SHTETIT PER RININE DHE FEMIJET .....	9
1.1.1.  STRATEGJIA KOMBETARE E RINISE 2022 - 2029 .....	10
1.2.  AGJENCIA KOMBETARE E RINISE (AKR) .....	12
1.3.  REGJISTRI ELEKTRONIK PER RININE (RER).....	15
1.4.  KESHILLI KOMBETAR RINOR .....	16
1.5.  KËSHILLI VENDOR I RINISE.....	17
1.6.  ORGANIZATA PERFAQESUESE RINORE .....	17
1.7.  INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE ME KOMPETENCA NE FUSHEN E RINISE.....	18
1.7.1.  GARANCIA RINORE.....	18
2. KAPITULLI: IMPLEMENTIMI I LIGJIT TE RINISE NE NIVEL LOKAL .....	22
2.1.  PËRBËRJA E KËSHILLIT VENDOR I RINISE.....	22
2.2.  REALIZIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT VENDOR TE RINISE .....	23
2.3.  NUMRI I MBLEDHJEVE TË KVR.....	24
2.4.  PAJISJA ME DOKUMENT STRATEGJIK PËR RININË.....	24
2.5.  PËRFSHIRJA NË PROJEKT-BUXHET E ZËRAVE TË DEDIKUAR PËR RININË.....	25
2.6.  MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE RAPORTIMI I TË DHËNAVE PËR SITUATËN E TË DREJTAVE TË TË RINJVE NË TERRITORIN E SHKIVE.....	25
2.7.  NDËRTIMI I DATABASËS SË TË DHËNAVE.....	26
2.8.  BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE.....	26
2.9.  BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË TË RINJVE SHQIPTAR NË DIASPORË.....	27

2.10.	ANGAZHIMI PËR MASAT SKR-SË 2022-2029 .....	27
2.11.	STRUKTURAT ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJET E RINISË.....	27
	PERFUNDIME .....	28
3.	KAPITULLI: PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE/PËR TË RINJTË PËR ZBATIMIN E LIGJIT 75/2019 “PËR RININË” .....	29
3.1.	NIVELI I INFORMIMIT DHE PERCEPTIMIT MBI ZBATIMIN E PËRGJITHSHËM TË LIGJIT 75/2019 DHE SKR.....	29
3.2.	PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE PER IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TE RINISE NE NIVEL QENDROR.....	32
3.3.	PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PER IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TE RINISE NE NIVEL LOKAL .....	35
	PËRFUNDIME .....	36
4.	KAPITULLI: PERCEPTIMI I TE RINJVE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT 75/2019 “PER RININE” .....	38
4.1.	NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 “PER RININE” .....	38
4.2.	PERCEPTIMI MBI ZBATIMIN E LIGJIT 75/2019 “PER RININE” NË NIVEL VENDOR .....	39
4.3.	PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI ROLIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË .....	43
	PËRFUNDIME .....	42
	BIBLIOGRAFIA .....	43

# LISTA E SHKURTIMEVE

- AKR** Agjencia Kombetare e Rinise
- AKSHI** Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit
- GR** Garancia Rinore
- INSTAT** Instituti i Statistikave ne Republiken e Shqiperise
- JAPFP** Jo ne Arsim, Punesimin apo Formim Profesional
- KKR** Keshilli Kombetar Rinor
- KRK** Kongresi Rinor Kombetar
- KLSH** Kontrolli i Lartë i Shtetit
- KVR** Keshillat Vendor i Rinise
- MSHRF** Ministri i Shtetit per Rinine dhe Femijet
- NEET** Jo ne punesim, arsim apo trajnim
- OKPR** Organizata Kombetare Perfaqesuese Rinore
- OSHC** Organizatat e Shoqerise Civile
- OJF** Organisate jo Fitimprures
- PZGR** Plani i Zbatimit i Garancise Rinore
- RER** Regjistri Elektronik per Rinine
- SKR** Strategjia Kombëtare e Rinisë
- VKM** Vendim i Keshillit te Ministrave

# PARATHËNIE

Ne kete raport paraqitet analize e pergjithshme e zbatimit te Ligjit 75/2019 "Per Rinine" ne vazhden e raporteve te monitorimit te realizuara nga Kongresi Rinor Kombetar qe prej vitit 2021 ne kuader te Programit te Kerkimit, Monitorimit dhe Vleresimit. Analiza bazohet ne përpunimin e nje sere te dhenash sasiore dhe cilesore duke evidentuar sfidat ekzistuese dhe paraqitur rekomandime per permiresimin e situates aktuale. Po ashtu në raport integrohen edhe perceptime të aktoreve te tjere sociale qe preken ne menyre te drejteperdrejte nga ky proces siç jane organizatat e shoqerise civile me fokus tek organizatat rinore/per te rinjte dhe vete te rinjte.

Kongresi Rinor Kombetar me mbeshtetjen e plote te Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer qe prej vitit 2019 i ka kushtuar vemendje te veçante zhvillimeve te Ligjit 75/2019 "Per Rinine" (Ligji) si i pari ligj kuader per sektorin e rinise zbatuar ne Shqiperi. Ne vitin 2021, KRK publikon te parin raport monitorimi mbi zbatimin e Ligjit, i titulluar 'Sfidat dhe Efektet e Zbatimit te Ligjit 75/2019 'Per Rinine''. Ky raport permban te dhena sasiore dhe cilesore mbi zbatimin e ligjit ne nivel qendror e lokal, duke bere nje analize mbi ecurine e ketij ligji, sfidat dhe problemet ekzistuese dhe duke paraqitur nje sere rekomandimesh per permiresimin e situates aktuale.

Ne vitin 2022 publikohet raporti i dyte i monitorimit i titulluar "Implementimi i Ligjit per Rinine: Perceptimi i te Rinjve dhe Oshc-ve". Ne kete raport perditsohen te dhenat te raportit te meparshem mbi ecurine e implementimit te ligjit ne nivel lokal e qendror, si dhe pasurohet me elemente te tjere si perfshirja edhe e perceptimve te aktoreve sociale qe preken ne menyre te drejteperdrejte siç jane organizatat rinore/per te rinjte dhe vete te rinjte.

KRK synon të vazhdojë monitorimin dhe trajtimin e çështjeve që prek ligji për të rinjtë dhe harton raportin e vitit 2023 i quajtur 'Monitorimi dhe raportimi mbi politikat rinore në nivel qendror- Ligji 75/2019 'Për rininë'' dhe politikat/strukturat në zbatim të tij 2023'. Nepermjet ciklit te ketyre raporteve, synohet te kontribuojme dhe vijme ne ndihme jo vetem sektorit te shoqerise civile, por edhe institucioneve publike, akademise, eksperteve te sektorit rinor, gjithë aktoreve qe operojne ne sektorin e politikave publike, mireqeverisjes, transparences dhe llogaridhenies si dhe dialogut te strukturuar midis institucioneve dhe aktoreve sociale ne Shqiperi. Ne nivel makro, ky raport sherben si nje baze te dhenash per te pasuruar argumentimin shkencor mbi ndryshimet dhe nderhyrjet qe duhen bere per permiresimin e sektorit rinor ne vendin tone.

# METODOLOGJIA

Raporti është hartuar duke përdorur metodologji mikse të mbledhjes dhe perpunimit të të dhënave. Dokumenti është konceptuar në tre faza dhe përmban të dhëna sasiore dhe cilësore të përditësuara lidhur me Ligjin 75/2019 "Për Rininë". Pasurohet me elemente të tjera si përfshirja e perceptimeve të aktoreve sociale që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë siç janë organizatat rinore/ për të rinjte dhe vete të rinjte.

**Faza e parë** e hartimit të këtij raporti lidhet me kampionimin, identifikimin dhe hartezimin e aktoreve kyç të cilët janë jo vetëm objekt i vezhgimit dhe monitorimit nga ana e Kongresit Rinor Kombëtar por janë edhe kontribuesit kryesorë të gjetjeve dhe rekomandimeve që janë përfshirë në këtë studim. Me qëllim përditësimit të kuadrit të përgjithshëm mbi Ligjin "Për Rininë" dhe zhvillimet e tij në nivel meret në analizë Ministri i Shtetit për Rininë dhe Femijet dhe Agjencin Kombëtare të Rinisë.

Për përditësimin e të dhënave dhe analizës të zbatimit të ligjit në nivel lokal përfshihen 61 NJVV-te. Në raportin e vitit 2023 janë përgjigjur 35 bashki kërkesës për informacion, pra rreth 57% e tyre. Bashkitë që janë përfshirë në studim janë bashkia: Belsh, Berat, Bulqizë, Devoll, Divjakë, Durrës, Fier, Finiq, Gjirokastër, Gramsh, Himarë, Kamëz, Klos, Kuçovë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Peqin, Pogradec, Përrenjas, Pucotec, Pukë, Roskovec, Sarandë, Shkoder, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Vau-Dejës, Vlorë, Vorë.

Hapësirë të rëndësishme në këtë studim zenë dhe organizatat rinore/për rininë. Është hartuar pyetësor online adresuar Organizatave të Shoqërisë Civile, konkretisht atyre rinore/për rininë me qëllim matjen e perceptimit të tyre nëse dispozitat e ligjit po përkthehen në mënyrë efektive apo masa të zbatueshme në dobi të të rinjve.

Kampioni i fundit i përfshirë në këtë studim përbehet nga të rinjtë. Qëllimi i përfshirjes së këtij kampioni është jo vetëm matja e nivelit të informimit të tyre lidhur me Ligjin për Rininë por edhe analiza e perceptimit të tyre lidhur me strukturat që parashikon ky ligj si dhe detyrat/përgjegjësitë që çdo aktor duhet të përmbushë. Në këtë kuader është hartuar pyetësori online adresuar të rinjve për të matur perceptimin e tyre mbi implementimin e Ligjit 75/2019 "Për rininë". Janë përfshirë 103 të anketuar ku 95 % e tyre janë 15-29 vjeç dhe jetojnë në 12 qarqet e Shqipërisë. Nga përgjigjet e të rinjve evidentohet se 71.4% e tyre nuk janë aktualisht të angazhuar/pjesë e një organizate rinore/ për rininë dhe 28.6% e tyre janë.

**Faza e dytë** bazohet tek rishikimi i literaturës ekzistuese, kërkimi paraprak dhe vlerësimi i dokumentave apo njoftimeve publike nga burime dytesore si raporte zyrtare, Vendime të Këshillit të Ministrave, njoftime në faqet zyrtare të institucioneve, postime në rrjete sociale ose kanale të tjera të medias si dhe deklaratat për shtyp.

**Faza e tretë** e metodologjisë përfshin procesin e perpunimit dhe analizimit të të dhënave dhe draftimin e raportit.

# 1. KAPITULLI: IMPLEMENTIMI I LIGJIT PER RININE

Ligji 75/2019 'Për rininë' është ligji i parë kuadër për sektorin e rinisë. Objekti i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë.<sup>1</sup> Ndër të tjera, ky ligj prezanton disa koncepte të rëndësishme duke kontribuar në kuadrin konceptual dhe ligjërues në fushën e rinisë.

Në këtë kapitull do të paraqitet kontekst dhe analizë e përgjithshme mbi detyrimet kryesore sipas Ligjit 75/2019 "Per Rinine" bazuar kryesisht tek kerkimi dhe vleresimi i dokumentave apo njoftimeve publike nga burime dytesore dhe komplementare si raporte zyrtare, Vendime te Keshillit te Ministrave, njoftime ne faqet zyrtare te institucioneve, kanale te tjera te medias si dhe deklarata per shtyp.

Si vijon paraqitet një përmbledhje e konstatimeve dhe rekomandimeve kryesore të paraqitura në këtë kapitull.

## **Konstatime:**

Pavarësisht rekomandimeve të KLSH në janar të vitit 2023, nuk vërehet progres në realizimin e tyre nga ana e MSHRF-së. Informacioni i përditësuar mungon në faqen zyrtare për buxhetin e rinisë, vlerësimet e situatës së të rinjve dhe monitorimin e politikave dhe aktiviteteve rinore.

Strategjia ka hyrë në vitin e dytë të zbatimit, por raportet e monitorimit mungojnë në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR. Ministri Muzhaqi ka paralajmëruar mbajtjen e Konferencës Vjetore të Rinisë në fillim të 2024, por deri në dhjetor 2023 nuk ka informacion të publikuar për ecurinë e përzgjedhjes së organizatave që mbështesin Konferencën.

Pas rekomandimeve të KLSH, AKR ka përmirësuar procedurat për monitorimin e zbatimit të projekteve nga grantet e akorduara. Sidoqoftë, raportet e monitorimit dhe vlerësimet të performancës së fondit grant për rininë nuk janë të disponueshme në faqen publike të AKR.

Nga kërkitimi në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR nuk ka informacion mbi nivelin e angazhimit dhe kontributit të Këshillit të parë Kombëtar të Rinisë apo dhe Këshillit të dytë për të vlerësuar mbi realizimin e rolit dhe kompetencave që KKR.

Në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR nuk ka informacion të përditësuar lidhur me procesin e ngritjes së OKPR-së.

Megjithëse në PZGR është parashikuar dhe sugjeruar krijimi i një dinamike vendore - ku angazhohen OJF, bashki, zyra pune vendore dhe partnerë të tjerë e aftë të zhvillojë strategjitë e komunikimit dhe informimit me të rinjtë, në fazën e parë të zbatimit të skemesë së pilotimit ne nentor 2023 ne qytetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlores vihet re shmangia e angazhimit të OJF-ve rinorë/për rininë. Aktualisht është vlerësuar të angazhohen vetëm Këshillat Vendorë te Rinisë. Është për tu vlerësuar në vijim niveli i angazhimit për OJF rinore/për rininë në këtë proces.

## **Rekomandime:**

- *MSHRF duhet të publikojë informacion të plotë dhe të përditësuar në lidhje me buxhetin, vlerësimet e situatës së të rinjve dhe bashkëpunimin me NJVV-te.*
- *Të zbatohen mekanizmat institucionalë për monitorimin e Strategjisë dhe të bëhen publike raportet e monitorimit çdo 6 muaj.*
- *Të organizohet Konferenca Vjetore e Rinisë nga MSHRF dhe të angazhohen organizata rinore për realizimin e Konferencës dhe vlerësimin vjetor të SKR, përzgjedhur në mënyrë publike dhe transparente.*
- *Të merren masa për monitorimin e zbatimit të projekteve, për të vlerësuar rezultatet dhe ndikimin e tyre dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve publike dhe te behen publike këto*

<sup>1</sup> Ligji nr. 75/2019 'Për rininë' neni 1/2/4



raporte nga AKR.

- Të rishikohet ligji për rininë për të përfshirë grantimet për individët dhe grupet joformale dhe të sigurohet transparencë të plotë në procesin e vlerësimeve të projekteve.
- Të sigurohet angazhimi dhe kontributi i Këshillit Kombëtar të Rinisë në realizimin e kompetencave të tij dhe të bëhet publik informacioni mbi angazhimin e Këshillit.
- Të rishikohen kriteret për përfaqësimin në Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore për të lehtësuar procedurat dhe të mundësohet përfaqësimi më gjithëpërfshirës.
- MSHRF të konsolidojë sistemin e monitorimit për zbatimin e masave që targetojnë rininë dhe të publikohen raportet e monitorimit për vendimarrje të informuar dhe rritje të transparencës.
- Të realizohen parashikimet e planit të veprimit të GR-së për angazhimin e institucioneve vendore dhe organizatave rinore / për rininë në fazat e zbatimit të Garancisë Rinore.

Si vijon paraqitet analiza e detajuar e situatës aktuale për disa nga detyrimet/institucionet kryesore të parashikuara/adresuara në Ligjin 75/2019 'Për rininë'.

## 1.1. MINISTRI I SHTESTIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Në bazë të vendimit nr. 524, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të shtetit për rininë dhe fëmijët', "Rinia" është fushë e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, duke u kaluar nga përgjegjësi e ish Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Sipas VKM-se ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka funksion kryesor hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve.

Kompetencat e ministrise përgjegjëse për rininë trajtohen dhe në Ligjin 75/2019 "Per Rinine" se bashku me kompetencat për strukturat e tjera që trajtojnë çështjet e rinisë.



Tabela 1: Ligji 75/2019 "Per Rinine", neni 5

Kontrrolli i Larte i Shtetit, në Raportin Perfundimtar të Auditimit të Perputhshmerie për MSHRF dhe AKR, publikuar në Janar 2023 konstaton se për periudhën me objekt auditimi nga 1 janar 2021 deri 31 gusht 2022: 'Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, nuk ka hartuar, zhvilluar dhe monitoruar politikat, për marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës; sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës; parashikimin e mekanizmave efektive dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës'.<sup>2</sup>

2 - Kontrrolli i Larte i Shtetit, 'Raport Perfundimtar, Auditim Perputhshmerie për MSHRF dhe AKR', Janar 2023, faqe <https://rinia.gov.al/ewp-content/uploads/2023/12/Raport-auditimi-KLSH.pdf>

Nga KLSH është lene rekomandim që të 'meren masa të menjehershme lidhur me hartimin dhe publikimin e raporteve të vlerësimit të situatës së të rinjve, monitorimi i politikave dhe veprimtarive rinore, monitorimi i standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore duke dhënë në këtë mënyrë një vlerësim aktual mbi situatën reale të të rinjve në Republikën e Shqipërisë.'

**Konstatim:** Pavarësisht se ky rekomandim nga KLSH është lene në janar të vitit 2023, nuk konstatohet se ka progres pozitiv në realizimin e tij. Në faqen zyrtare të MSHRF-së nuk pasqyrohet informacion i përditësuar mbi: buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë; raporte vlerësimi mbi situatën e të rinjve; monitorimin dhe zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; monitorimin e standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë, apo bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, projektet e programet në fushën e rinisë në zbatim të nenit 5 të ligjit. Në faqen zyrtare të MSHRF-së përditësohet informacion i përmuajshëm në 'ditarin mbi aktivitete të ndryshme me mbështetjen/pjesëmarrjen e MSHRF-së.<sup>3</sup>

**Rekomandim:** Të publikohet informacion nga MSHRF mbi zbatimin e detyrave që ngarkon Ligji si: buxhetin për financimin e veprimtarive në fushën e rinisë; raportet e vlerësimit mbi situatën e të rinjve; monitorimin dhe zbatimin e politikave, si dhe të veprimtarive rinore; monitorimin e standardeve për ndërtimin e hapësirave rinore të sigurta dhe të aksesueshme për të rinjtë'; bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, projektet e programet në fushën e rinisë.<sup>4</sup>

### 1.1.1. STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË 2022 - 2029

Neni 5 i këtij ligji përcakton në pikat a dhe g përgjegjësinë e ministrit përgjegjës për rininë për të hartuar dhe propozuar bazën ligjore dhe politika të veprimtarive për rininë si edhe zhvillimin e konsultimeve me të rinjtë lidhur me politikën. Si rrjedhojë kjo ministri ka marrë drejtimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 miratuar me VKM Nr. 692, datë 26.10.2022<sup>5</sup>. Procesi për hartimin e Strategjisë ka filluar në vitin 2019 nën drejtimin e ish MASR-së duke qenë se në dhjetor 2020 përfundonte zbatimi i "Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020". Duke marrë parasysh kalimin e kompetencave nga MAS-i të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka pasur disa ndryshime dhe vonesa në procesin e hartimit të strategjisë sipas planifikimit të realizuar nga ish MASR.

SKR 2022- 2029 përfshin 3 qëllime, 9 objektiva specifike dhe një sërë masash dhe aktiviteteve të cilat është konsultuar me palë interesit si dhe rakorduar me institucionet shtetërore. SKR parashikon hartimin e politikave për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri dhe adresimin e problemeve me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si përfshirja në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve rekreative, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizmi etj.<sup>6</sup>

#### **Qëllimet politike të SKR si prioritet janë:**

- 1- Të rejtat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikën ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.
- 2- Mbështetjet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejtave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur

3 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ditari Mjor, Faqja Zyrtare, <https://Riniafemijet.Gov.AL/ewp-Content/Uploads/2023/04/Ditari-Mujor-Mars-2023.Pdf>

4 Kontrolli i Lartë i Shtetit, 'Raport i Profundimitar, Auditim i Perputhshmerie per MSHRF dhe AKR', Janar 2023 <https://rinia.gov.al/ewp-content/uploads/2023/12/Raport-auditimi-KLSH.pdf>


5 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, Datë 26.10.2022 'Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029'.

6 Vendim i Këshillit të Ministrave nr.91, datë 9.2.2022, 'Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024'

dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

- 3- Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Kosto totale e parashikuar e strategjisë për të tetë vitet është 5,570,086,793 lekë dhe hendeku financiar është 18.6% me -1,040,395,542 lekë.



Grafiku nr. 2: Përbërja e kostove sipas burimit të financimit

Sipas të dhënave të publikuara në strategji, 71 % e kostove mbulohej nga buxheti i shtetit dhe lidhen me pagat, investimet kapitale dhe grantet që qeveria jep nëpërmjet AKR, KOKSH (Ministria e Arsimit dhe Sportit), Fondet për Startup, apo edhe fonde që mbështesin iniciativa si zgjerimi i njohurive për kodimin, 10.3% financohet nga donatorët si organizatat e UN (UNICEF, UNFPA), fondet e BE, RYCO, AADF etj. dhe 18.7% janë kosto të pambuluara.<sup>7</sup>

Organizimi institucional i menaxhimit dhe të monitorimit të strategjisë është i parashikuar të jete me disa niveleve. Niveli i parë përbëhet nga institucioni kryesor - MShRF - që koordinon SKR-në në institucionet pjesëmarrëse me anë të Personave të Kontaktit (PK) të përcaktuar në çdo ministri dhe institucion varësie që lidhet për të koordinuar zbatimin e SKR-së me MShRF.

Niveli i dytë përbëhet nga Grupi Ndërqeveritar i Monitorimit të SKR-se i përbërë nga përfaqësuesit e emëruar zyrtarisht nga ministratë përkatëse. Sipas planifikimit në Strategji çdo gjashtë muaj pranë këtij grupi duhet të dorëzohet raport monitorimi i përgatitur nga AKR. Sipas parashikimit, MSHRF do të duhet të përdorë metodologjinë e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS në zbatim të VKM nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)" për përgatitjen e raporteve të monitorimit.

Niveli i tretë parashikohet të përbëhet nga Konferenca Vjetore e Rinisë në të cilën pritet të bëhet vlerësimi vjetor të SKR-së përmes angazhimit të organizatave rinore/për rininë. Procesi i përzgjedhjes duhet të përcaktohet me udhëzime të MShRF-së dhe organizatat e përzgjedhura mund të bashkëpunojnë edhe me organizata ndërkombëtare në fushën e rinisë dhe donatorë për të mbështetur realizimin e konferencës dhe procesin e vlerësimit vjetor të SKR-së.<sup>8</sup>

**Konstatim:** Strategjia ka hyrë në vitin e saj të dytë të zbatimit. Në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR nuk gjenden të publikuar raporte monitorimi. Sipas deklaratave mediatike nga Ministri Muzhaqi, pritet në fillim të 2024 të organizohet Konferenca Vjetore e Rinisë. Deri në dhjetor 2023 nuk ka informacion të publikuar lidhur me ecurinë e përzgjedhjes së organizatave të cilat sipas paashikimit në Strategji, mbështesin realizimin e Konferencës dhe procesin e vlerësimit vjetor të SKR-se.

<sup>7</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, Datë 26.10.2022 'Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029'.

<sup>8</sup> MSHRF, Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029, <https://rriiafemijet.gov.al/ewp-content/uploads/2023/04/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029.pdf>

## Rekomandime:

- Te vihet ne zbatim mekanizmi institucional per monitorimin e Strategjise dhe berja publike e raporteve te monitorimit te saj ne baza 6 mujore.
- Te realizohet Konferenca Vjetore e Rinise nga MSHRF ne te cilen te angazhohen organizata rinore qe mbështesin realizimin e Konferencës Vjetore te Rinise dhe procesin e vlerësimit vjetor të SKR, përzgjedhur sipas një procedure publike transparente.

## 1.2. AGJENCIA KOMBETARE E RINISE (AKR)

### Neni 8 Institucioni përgjegjës për rininë

2. Institucioni përgjegjës për rininë kryen këto funksione:

- a) zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;
- b) organizon, administron, financon, koordinon dhe monitoron e mbikëqyr programet dhe projektet rinore;
- c) bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase e të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;
- d) mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor;
- e) krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë;
- f) siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar;
- g) mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- h) raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj;
- i) mbikëqyr veprimtarinë rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji.

Tabela 3: Ligji 75/2019 'Per Rinine', neni 8

Agjencia Kombetare e Rinise është krijuar ne 2 shtator 2020 duke zevendesuar Sherbimin Kombetar te Rinise. Misioni i AKR-së është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimit e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.<sup>9</sup>

Veprimtaria e AKR-se shtrihet ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë duke organizuar përgjegjesite funksionale me qellim sigurimin e kushteve per mbeshtjetjen dhe nxitjen e veprimtarive rinore, zhvillimin e dialogut te strukturuar per te realizuar fuqizimin e pozites se te rinjve ne shoqeri, krijimin e mekanizmave per nxitjen e politikave rinore si dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilesore e te pavarura, ne perzgjedhjen e programeve dhe projekteve qe kane ne fokus rinine shqiptare dhe rendesine e kesaj te fundit ne shoqeri. Në faqen zyrtare të AKR konstatohet mangësi në publikim të raporteve të monitorimit lidhur me veprimtarinë e këtij institucioni. Ndërkaq, gjendet informacion i publikuar mbi 3 thirrjet për përfitimin e granteve te dedikuar per rinine.

<sup>9</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 2.9.2020 'Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të agjencisë kombëtare të rinisë. (AKR)'

## Thirrja 1

Nepermjet fondit grant te dedikuar per rinine, AKR-ja financon projekte rinore te organizatave rinore dhe/ose per te rinjte, apo Njesite e Veteqeverisjes Vendore. Duke ju referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 75/2019 "Për rininë", Organizatat për të Rinj janë organizata që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre veprimtari rinore si dhe kanë zbatuar për një periudhë të paktën 3-vjeçare, në mënyrë të vazhdueshme, projekte e programe me impakt tek të rinjtë. Organizatat Rinore janë organizata që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre veprimtari rinore dhe 70% të anëtarëve janë të rinj.<sup>10</sup>

Projektet rinore te financuara nepermjet thirrjes nr.1 ishin ne total 16, 12 per organizatat rinore dhe 4 per NJVV-të. Financimet per bashkite perfshijnë kryesisht qendra rinore, biblioteka dhe qendra kulturore ndersa financimet qe u akorduan organizatave rinore ose per te rinjte kishin ne fokus punen edukuese dhe informuese me te rinjte. 12 organizatat kane perfituar ne total 28 722 680 lek ndersa 4 bashkite kane perfituar ne total 19 136 851 lek, pra rreth 40% e fondit ka shkuar vetem per 4 bashki.<sup>11</sup>

## Thirrja 2

Në Thirrjen e dytë për Projekt-propozime Rinore janë kualifikuar për tu financuar 24 projekte rinore për OJF rinore/për të rinj, me shume maksimale financimi ne 1.500.000 leke per organizatat rinore dhe me shume maksimale financimi 3.500.000 lekë per organizatat për të rinjtë.<sup>12</sup> Projekt-Propozimet e dorëzuara nga organizatat rinore dhe për të rinjtë duhet të kishin në fokus rininë referuar prioriteteve te meposhtme:

1. Nxitja e novacionit rinor dhe aftësive digjitale të shekullit të 21-të tek të rinjtë.
2. Mbështetja e këshillimit në karrierë dhe ndërlihdjes së të rinjve me tregun e punës.
3. Mbështetja e mirëqënies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Po ashtu jane shpallur fitues 5 Bashki: Durrësit, Dibrës, Gjirokastrës, Lushnjës dhe Kamzës, si duke mbështetur rikonstruktimin dhe ndërtimin e 3 bibliotekave të reja në Dibër, Lushnjë dhe Kamëz, të konceptuara edhe si hapësira multifunktionale. Ndërkaq u financua dhe rindërtimi i Qendres Rinore Multifunktionale në Bashkinë Durrës dhe Gjirokastrë. Ashtu si dhe në thirrjen e parë, fondet qe u ndahen NJVV-ve janë për projekte fokusuar në investime kapitale në infrastrukturë dhe pajisje të lidhura me rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe funksionimin e objekteve publike, pjesë e infrastrukturës rinore si: qendrat rinore, bibliotekat, qendrat rekreative për të rinjtë.

Shuma e financimit për projektpropozim ishte deri 10.000.000 lekë me kushtin qe NJVV duhet të bashkëfinancojë projektpropozimin me të paktën 10% të shumës së financimit të kërkuar nga AKR-ja. Totali i grantit për këtë Thirrje ka qenë 50.000.000 Lekë.<sup>13</sup>

## Thirrja 3

Ne muajin maj 2023 eshte shpallur Thirrja e tretë për Projekt-propozime Rinore drejtuar organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë referuar këtyre prioriteteve:

1. Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetja e aktivizmit shoqëror dhe qytetar të tyre.

<sup>10</sup> AKR, Pyetje të shpeshta mbi Thirrjen Publike Nr.1 'Për Projektpropozime, Drejtuar Organizatave Rinore dhe për të Rinjtë', <https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/FAQ-OJF-Thirrja-2.pdf>

<sup>11</sup> Dafina Peci, Enxhi Lipa, Rigels Xhemollari, (2022) 'Implementimi i Ligjit për Rininë, Përceptimi i të Rinjve dhe OS- HC-ve'

<sup>12</sup> AKR, 'Thirrja e dyte', <https://rinia.gov.al/thirrja-e-2te/>

<sup>13</sup> AKR, 'Udhëzues për aplikantët –njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të thirrjes publike për projekt propozime (ii)' [https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/04/Udhezuesi-i-aplikimit\\_NJVV.pdf](https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/04/Udhezuesi-i-aplikimit_NJVV.pdf)

2. Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
3. Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrje publike është e njëjte me atë të thirrjes II: ku shuma maksimale për organizatat rinore që mund të jepet është deri në 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) leke dhe shuma maksimale për organizatat për të rinjtë deri në 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë.<sup>14</sup> Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qene 26 maj 2023 dhe ne vijim është publikuar një liste me renditje paraprake e organizatave të pikëzuara për thirrjen e tretë për projekt propozime nga organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë me 46 OJF<sup>15</sup> Ndërkohë kanë kaluar fazën finale dhe janë nënshkruar kontratat për 23 projekt propozime. Ne dhjetor 2023 është shpallur po ashtu dhe Thirrja e tretë për Projekt-propozime Rinore për NJVV-të me të njëjtat kushte si thirrjet e tjera. Afati i aplikimit është deri ne 7 janar 2024.

Mbështetja financiare për thirrjen e tretë të vitit 2023, ashtu si edhe vitin e kaluar, është mbështetur nga buxheti i shtetit por edhe edhe nga donatorët, respektivisht: 'UNICEF, UNDP dhe UNFPA. Totali i grantit për mbështetjen e organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë në këtë thirrje është 58.000.000 Lekë nga buxheti i shtetit dhe afro 6.000.000 Lekë nga donatorët.'<sup>16</sup>

Kontrrolli i Lartë i Shtetit, në Raportin Perfundimtar të Auditimit të Perputhshmerisë për MSHRF dhe AKR, publikuar në janar 2023 konstaton për thirrjen I se 'nuk ka pasur plan monitorimi periodik me objektiva të qarta, e cila ka çuar në mungesën e një analize të hollësishme në ecurinë e projekteve të investimeve.....Monitorimi i projekteve duhet parë si një funksion thelbësor i aktivitetit të AKR-së, për të cilin duhet të ngrihen dhe funksionojnë struktura të plota dhe aktive, të afta të mbulojnë me monitorim një pjesë përfaqësuese të projekteve në mënyrë që të merret siguri e arsyeshme mbi përdorimin me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike'.<sup>17</sup>

**Konstatim:** Bazuar në rekomandimin e lënë nga KLSH, AKR ka përmirësuar procedurën për monitorimin e zbatimit të projekteve. Vendimi nr. 1141, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave që regullonte procedurat për thirrjet, shfuqizohet dhe miratohet VKM nr. 566, datë 29.7.2022 'Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë', duke pasuruar dhe përmirësuar aspektet menaxheriale. Përsa i përket thirrjes së tretë, sic deklarohet nga ministër Muzhaqi, është aplikuar standard i ri i procesit të aplikimit dhe vlerësimit sipas metodologjisë LOD 'e cila përkon me rritjen e transparencës, eficientë, besueshmërisë, kontrollit dhe monitorimit dhe njëkohësisht rritjen e kapaciteteve të stafit që menaxhon këtë Thirrje'.<sup>18</sup>

Në vendimin nr. 566 parashikohet po ashtu që AKR-ja të kryejë çdo vit vlerësimin e performancës së fondit grant për rininë, që përfshin vlerësimin e menaxhimit të thirrjes nga AKR-ja, si dhe rezultatet dhe ndikimin e arritur nga projektet e financuara. Vlerësimi duhet të kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i zbatimit të projekteve të mbështetura në një program vjetor financimi dhe përmban, të paktën, elementet e mëposhtme:

14 AKR, 'Thirrja e Tretë për Projekt propozime', <https://rinia.gov.al/thirrja-e-trete-per-projekt-propozime-organizatat-rinore-dhe-organizatat-per-te-rinjte/>

15 AKR, 'Vlerësimet paraprake', <https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/08/vleresimet-paraprake.pdf>

16 MSHRF, 'Muzhaqi: 23 projekte fituese për fuqizimin e të rinjve', publikuar më: 29/09/2023, <https://riniafemijet.gov.al/muzhaqi-23-projekte-fituese-per-fuqizimin-e-te-rinjve-nenshkuam-marreshjet-me-23-organizata-fituese-nga-thirrja-e-trete-e-agjencise-kombetare-te-rinise/>

17 Kontrolli i Lartë i Shtetit, 'Raport Perfundimtar, Auditim Perputhshmerie per MSHRF dhe AKR', Janar 2023 <https://rinia.gov.al/ewp-content/uploads/2023/12/Raport-auditimi-KLSH.pdf>

18 MSHRF, 'Muzhaqi: 23 projekte fituese për fuqizimin e të rinjve/ nënshkuam marrëveshjet me 23 organizata, fituese nga Thirrja e Tretë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë'<https://riniafemijet.gov.al/muzhaqi-23-projekte-fituese-per-fuqizimin-e-te-rinjve-nenshkuam-marreshjet-me-23-organizata-fituese-nga-thirrja-e-trete-e-agjencise-kombetare-te-rinise/>

a) informacionin mbi thirrjet publike të zbatuara, sasinë e fondeve të shpërndara dhe shpenzimet e realizuara; b) informacionin mbi numrin e aplikimeve të thirrjes dhe përshkrimin e cilësive dhe të të metave të projektpropozimeve të kandidatëve; c) informacion mbi arritjet e ndikimin e projekteve të mbështetura dhe kontributin e tyre për realizimin e objektivave të shpallur të thirrjes publike; ç) numrin e ankimeve administrative të paraqitura dhe vendimet përfundimtare të shqyrtimit të tyre.<sup>19</sup>

Për sa më sipër, ne faqen publike te AKR nuk gjenden raporte monitorimi te thirrjeve dhe te impaktit qe keto projekte kane patur, ku te jetë vlerësuar përdorimi i fondeve publike në keto programe sipas VKM 566.

### **Rekomandim:**

- Të merren masa për monitorimin e zbatimit të projekteve, për të vlerësuar rezultatet dhe ndikimin e tyre si dhe nivelin e efikasitetit dhe efikasitetit për përdorimin e fondeve publike.
- Në rishikimin e ligjit për rininë të konsiderohet përfshirja e grantimit për individët dhe grupet joformale dhe nxjerjen e akteve nënligjore përkatëse për të rregulluar këto kategori grantimi.
- Të sigurohet transparencë të plotë në procesin e vlerësimeve të projekt – propozimeve, informacion mbi numrin e aplikimeve të thirrjes dhe përshkrimin e cilësive dhe të të metave të projektpropozimeve të kandidatëve; informacion mbi arritjet e ndikimin e projekteve të mbështetura dhe kontributin e tyre për realizimin e objektivave të shpallur të thirrjes publike; numrin e ankimeve administrative të paraqitura dhe vendimet përfundimtare të shqyrtimit të tyre.

## **1.3. REGJISTRI ELEKTRONIK PER RININE (RER)**

Në ligj është parashikuar ngritja e bazës së të dhënave për rininë e cila do të ketë për qëllim të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor. Bazuar në pikën 18/4 është publikuar VKM Nr.833, datë 24.12.2021 e cila paraqet rregulla të hollësishtme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave<sup>20</sup> Kjo bazë të dhënash parashikohet të shërbeje një si regjistër elektronik për rininë (RER) administruar nga AKR. Niveli i aksesimit në sistemin për personat e interesuar të bazës së të dhënave RER është parashikuar si më poshtë vijon:

- Të rinjtë, organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe Organizata Kombëtare Përfaqësuese për Rininë me nivel aksesit si lexues të RER-it e dërgues të kërkesave për informacion publik, nëpërmjet portalit "Për rininë";
- AKR me aksesit si administrator dhe përdorues i RER-it.
- 

Kjo bazë të dhënash sipas VKM synohet të ndërveprojë nëpërmjet shkëmbimit elektronik të të dhënave me: bazën e të dhënave të regjistrimit gjyqësor për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve); bazën e të dhënave të regjistrimit tregtar; bazën e të dhënave të informacionit të planifikimit të integruar – SIPI. Gjatë vitit 2023 është ngritur një grup pune me përfaqësues nga OJF për rininë/ rinore të cilët kanë dhënë komentet e tyre lidhur me përmbajtjen e databazës.

<sup>19</sup> Neni 21, VKM nr. 566, datë 29.7.2022 'Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë.'

<sup>20</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr.833, datë 24.12.2021 'Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore'.

**Konstatim:** Nuk ka informacion të përditësuar publik lidhur me ecurinë për ngritjen e databazës.

### **Rekomandime:**

- Ngritja e bazës së të dhënave për rininë duke u konsultuar me aktorët kryesorë të sektorit të rinisë përfshirë organizatat rinore/për rininë.
- Mundësimi i aksesit në informacion të organizatave rinore/për rininë.
- Të kihet në konsideratë elementët e sigurimit të të dhënave private/konfidenciale në ngritjen e databazës.

## **1.4. Keshilli Kombëtar Rinor**

### **Neni 9**

#### **Këshilli Kombëtar i Rinisë**

*Këshilli Kombëtar i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë ushtron kompetencat mëposhtme:*

- a) i paraqet ministrit përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë;*
  - b) propozon drejtimit dhe programet kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin epjesëmarrjes së të rinjve;*
  - c) jep mendim për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe monitoron zbatimin e saj;*
  - ç) miraton raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë dhe situatës së të rinjve.*
- 2. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.*
- 3. Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Tabela 4: Ligji 75/2019 “Per Rinine”, neni 8

Keshilli Kombëtar Rinor është parashikuar të jetë organ këshillimor pranë ministrit për Rininë. Me 24 mars 2021 u konstitua përberja e KKR së parë me përberjen e tij prej 14 anëtarësh, ku 8 janë përfaqësuar nga organizatat e shoqërisë civile, 4 nga shkollat dhe universitetet dhe 2 përfaqësues nga NJVV-të.

Në qershor të vitit 2023 Agjencia Kombëtare e Rinisë ka shpallur thirrjen e dytë për krijimin e Këshillit Kombëtar Rinor (KKR), si organ këshillimor, që funksionon pranë Ministrit përgjegjës për rininë. Edhe kjo KKR, sipas parashikimit ligjor, është e përbërë nga 14 anëtarë, ku 8 prej tyre përfaqësojnë OJF rinore/për të rinjtë, 4 anëtarë janë përfaqësues të Këshillave Studentorë dhe 2 janë përfaqësues së NJVV-ve.

### **Konstatim:**

Nga kërkimi në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR nuk ka informacion mbi nivelin e angazhimit dhe kontributit të Këshillit të parë Kombëtar të Rinisë apo dhe Këshillit të dytë për të vlerësuar mbi realizimin e rolit dhe kompetencave që KKR ka.

### **Rekomandim:**

- Të sigurohet angazhim dhe kontribut përmbytësor të organit kolegjial të Këshillit Kombëtar të Rinisë në realizimin e kompetencave të tij si: paraqitja tek ministri përgjegjës për rininë politikat prioritare, buxhetin dhe veprimtaritë në fushën e rinisë apo propozimin e drejtimeve dhe programeve kryesore për mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të



bëhet publik informacioni mbi angazhimin e Këshillit.

## 1.5. KËSHILLI VENDOR I RINISE

Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të bashkisë dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) këshillon njësitet e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë.<sup>21</sup>

Nga MSHRF konfirmohet se KVR-te janë ngritur ne te gjitha NJVV-te e vendit.

### **Rekomandim:**

Te monitorohet nga MSHRF ne bashkepunim me NJVV-te veprimtaria e KVR-ve, me indikator te cilet tregojne angazhimin permbajtësor te tyre dhe realizimi i kompetencave sipas nenit 10 te ligjit.

## 1.6. ORGANIZATA PERFAQESUESE RINORE

Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është institucion tjetër i parashikuar në Ligjin 'Për rininë' për tu themeluar, organizuar dhe funksionuar në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse. Gjatë vitit 2021 është hapur dy herë thirrja për të aplikuar dhe mundësuar krijimin e kësaj organizate por kanë qenë të pasukseshme. Thirrja është bazuar në kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 274, datë 12.5.2021 'Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë organizata kombëtare përfaqësuese rinore'. Një nga kriteret kryesore të OKPR-së është anëtarësia e jo më pak se 60 organizatave rinore dhe/ ose për të rinjtë, kriter që e vështirëson organizimin për pjesëmarrje dhe aplikim.<sup>22</sup>

**Konstatim:** Në faqet zyrtare të MSHRF dhe AKR nuk ka informacion të përditësuar lidhur me procesin e ngritjes së OKPR-së.

### **Rekomandim:**

- Të rishikohen në kuadrin ligjor/nënligjor kriteret për përfaqësim të OSHC-ve në Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore me qëllim lehtësimin e procedurave/kriterëve dhe mundësimin e përfaqësimit sa më gjithëpërfshirës.

<sup>21</sup> Neni 10, Ligji 75/2019 'Per rinine'

<sup>22</sup> VKM-në nr. 274, datë 12.5.2021, neni 2, pika c 'Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë organizata kombëtare përfaqësuese rinore'

## 1.7. Institucionet e tjera qendrore me kompetenca ne fushen e rinise




Tabela 5: Ligji 75/2019 "Per Rinine", neni 6

Neni 6 i ligjit adreson përgjegjësitë kryesore të institucioneve të tjera qendrore të cilat brenda fushës së veprimtarisë së tyre shtetërore. Rinia, duke qenë ndërsektoriale si fushë, trajtohet nga një shumësi politikash të cilat janë nën përgjegjësi të shumicës së institucioneve qendrore. Disa nga ministratë kryesore të cilat targetojnë politika rinore janë: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbështetjes Sociale; Ministria e Drejtësisë si dhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Secila prej këtyre ministrive ka të buxhetuara masa të cilat targetojnë rininë si dhe janë drejtues në hartimin dhe zbatimin e një serë politikash dhe dokumentash strategjike me masa specifike për rininë.

Nje nga programet kryesore ne proces zbatimimi per rinine eshte Skema e Garancise Rinore e cila koordinohet nga institucioni pergjegjes per punesimin dhe ekonomine trajtuar me gjerësisht në sesioni 1.6.1.

### **Rekomandim:**

- MSHRF të konsolidojë sistem monitorimi për zbatimin e të gjitha masave që targetojnë rininë në dokumentat strategjike ekzistues në tagrin e institucionit përgjegjës për fushën e rinisë, duke siguruar dhe zbatimin e tyre. Të publikohen raportet e monitorimit në mënyrë periodike për të siguruar vendimarrje bazuar në informacion dhe për të rritur transparencën në të gjithë aktorët e fushës së rinisë me masat dhe rezultatet e këtyre politikave.

### **1.7.1. GARANCIA RINORE**

Garancia Rinore eshte program 'Flamur' i BE-se i filluar qe ne vitin 2013 dedikuar te rinjve qe nuk jane ne punesim, arsimim apo formim profesional, duke synuar identifikimin dhe regjistrimin e tyre ne skeme, me qellim dhenien e nje oferte punesimi, formimi profesional apo arsim. Synimi për të miratuar skemën e Garancisë Rinore ne Shqiperi është vijimësi e "Deklaratës së Ballkanit Perëndimor për integrimi të qëndrueshëm të të rinjve në tregun e punës", nënshkruar në takimin e dytë ministror

BE- Ballkan Perëndimor mbi Punësimin dhe Çështjet Sociale, mbajtur nga Presidenca sllovene e Këshillit të BE-së më 8 korrik 2021. Në këtë takim, ministrat dhe përfaqësuesit e sektorit të punësimit në Ballkanin Perëndimor ranë dakord që "të adresojnë papunësinë e të rinjve" duke ritheksuar përkushtimin ndaj Shtyllës Evropiane për Të Drejtat Sociale se "të rinjtë kanë të drejtë për arsim të vazhdueshëm, nxënie në vendin e punës, praktika profesionale ose ofertë pune cilësore brenda 4 muajsh pasi ngelen të papunë apo braktisin arsimin".<sup>23</sup>

Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor i iniciuar nga Komisioni Evropian në tetor 2020 mbështet zbatimin e Garancisë Rinore në Shqipëri nëpërmjet katër fazave: Faza 1 – Përgatitja dhe miratimi i planit për zbatimin e Garancisë Rinore (IPA 2015); Faza 2 - Punë Përgatitore; Faza 3 - Faza Pilot (IPA 2019 dhe IPA 2022), Faza 4: Zgjerimi në të gjithë vendin që pritet të mbështetet nga Programi Operacional 'Punësimi Rinor i BE 2024-2027'.<sup>24</sup>

Aktualisht janë realizuar tre fazat e para të procesit si më sipër, duke filluar me hapin e parë që konfirmoi vullnetin institucional për zbatimin e skemës: miratimi i Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR) në mars 2023 si pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030.<sup>25</sup> Periudha mars-nentor 2023 ka qenë fazë përgatitore duke i paraprirë fazës së tretë të pilotimit. Pilotimi filloi në nentor 2023 në qytetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlores.



**Tabela 6:** çfarë është Garancia Rinore

### Modeli qeverisë dhe angazhimi i partnereve sociale

Skema e GR deri në dhjetor 2023 ka qenë nën koordinimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) si institucioni përgjegjës për politikën e punësimit dhe formimit profesional.<sup>26</sup> MFE koordinonte një grup të gjerë institucionesh nga fusha e punësimit, formimit profesional, arsimit si dhe rinisë. Menaxhimi i përditshëm i zbatimit të Garancisë Rinore parashikohet të bëhet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (shërbimi publik i punësimit) nën koordinimin e Koordinatorit Kombëtar të Garancisë Rinore.

Plani i Garancisë Rinore koordinohet nga zëvendësministri përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, i cili ka përgjegjësinë të monitorojë dhe të raportojë te Kryeministri dhe Komisioni Evropian mbi ecurinë e reformave dhe ndërhyrjeve të Garancisë Rinore, si edhe mbi sistemin e monitorimit dhe vlerësimit. Koordinatori GR ka edhe përgjegjësinë që të gjallërojë dhe të kryesojë punën e grupeve

<sup>23</sup> Plani i veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024

<sup>24</sup> Launching the youth guarantee pilot in Albania October 27, 2023, 9:00 – 12:00, at National Theater of Opera and Ballet

<sup>25</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 24.3.2023 'Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024'

<sup>26</sup> Ky raport përfshin ecurinë për vitin 2023. Me ndryshimet e reja në Kabinetin Qeveritar, krijimi i Ministrisë së Ekonomisë, Turizmit dhe Inovacionit, pritet të ketë dhe ndryshime në drejtimin e struktura qeverisëse të GR-se.

ndërinstitucionale dhe teknike të punës.

Pra, përveç Koordinatorit Kombëtar, janë ngritur dhe janë emëruar anëtarët e dy grupeve të punës sipas PSGR duhe zbatojnë dhe monitorojnë Garancinë Rinore: grupi ndërinstitucional i punës dhe grupi teknik i punës. Këto grupe duhet të jenë platformat kryesore të pjesëmarrjes për të mbështetur zbatimin e Planit dhe për të garantuar koordinimin e organeve publike, OJF-ve dhe partnerëve socialë. Sipas PZGR modalitetet e zbatimit synohet të përfshijnë pjesëmarrjen e palëve shumë-nivelëshe dhe mobilizimin e kontributit të OJF-ve, kryesisht ato që mbështetin të rinjtë (sidomos të rinjtë në situata vulnerabël) sipas kater fazat që strukturojnë zbatimin e GR-se si vijon:<sup>27</sup>

Faza e hartëzimit: synohet të përmbledhe reformat dhe nismat që synojnë të kemi një panoramë më të mirë dhe sistematike të të rinjve JAPFP, si edhe zbatimin e nismave të ndërhyrjes se hershme për të parandaluar rënien e të rinjve në situatën JAPFP.

Faza e komunikimit i jep prioritet dimensionit vendor me qëllim gjetjen dhe regjistrimin e të rinjve inaktivë JAPFP dhe përfshin hartimin e një strategjie komunikimi që synon të mbështetë PZGR. Per kete faze eshte parashikuar angazhimi dhe aktivizimi i rrjeteve vendore të bashkëpunimit, 'ku partnerët kryesorë mund të jenë bashkitë, organizatat rinore dhe zyrat vendore të punës.'<sup>28</sup>

Sipas Ligjit 'Për Rininë', Këshillat Vendorë të Rinisë (KVR) kanë kompetencën që "të vlerësojnë situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor". Përveç kësaj, i njëjti ligj përcakton se organizatat për të rinjtë "kanë për qëllim mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim për të rinjtë". Prandaj, Këshillat Vendorë të Rinisë janë vlerësuar si platformë për tu angazhuar për fazën e komunikimit, në bashkëpunim me punonjësit rinorë në secilin bashki dhe të luajnë rol kyç në identifikimin dhe kontaktimin e JAPFP-ve në zona të ndryshme të Shqipërisë.<sup>29</sup>

Per nje zbatim sa me eficient te fazes se komunikimit duke angazhuar partneret social, ne PZGR eshte sugjeruar te meren disa masa mbeshtetese per rritjen e kapaciteteve institucionale:

- 'Të hartëzohen (përcaktohen) institucionet vendore duke pasur parasysh Këshillat Vendorë të Rinisë që mund të luajnë rol relevant në zbatimin e strategjisë së komunikimit në ndihmë të zyrave vendore të punës.
- Të hartohet një program forcimi kapacitetesh (trajnim i personelit teknik të organizatave të ndryshme) dhe i burimeve metodologjike (udhëzime, burime informacioni, paketa trajnimesh të shkurtra) që u drejtohen të gjithë llojeve të partnerëve.
- Të zbatohet një skemë grant që synon të mbështetë organizatat rinore mbi zhvillimin e rolit të tyre në strategjinë e komunikimit, kryesisht në dhënien e informacionit dhe trajnimeve për rininë.'<sup>30</sup>

Sipas PZGR, OJF-të bashkë me organizatat rinore duhet të luajnë rol qendror në këtë përfaqesë vendore, por jo vetëm në lidhje me strategjinë e komunikimit. Ato mund të ofrojnë edhe disa shërbime specifike të planifikuara në fazën pasuese të Planit. Prandaj, përfshirja e OJF-ve në PZGR do të kërkojë një proces përzgjedhjeje. Kjo përzgjedhje do t'u lejojë OJF-ve të zgjedhin fushat ku dëshirojnë të ndërhyjnë dhe rrjedhimisht të kenë akses në paketat e forcimit të kapaciteteve që me kompetencat e përforcuara të luajnë rol relevant në zbatimin e Planit.

OJF-të që përzgjidhen për të qenë pjesë e fazave të komunikimit dhe shërbimeve, duhet të përfitojnë një grant që mbështet aktivitetin e tyre në arritjen e objektivave për të cilat kontraktohen. Me OJF nënkuptohen organizatat për të rinjtë dhe OJF-të me objekt të gjerë ndërhyrjeje, por me ekspertizë kontaktimin e JAPFP-ve në zona të ndryshme të Shqipërisë. Sipas sugjerimit në Plan, procesi i përzgjedhjes duhet të mbajë parasysh që OJF-të që mund të realizojnë tri detyra: 1. Identifikimi dhe regjistrimi i JAPFP; 2. Diagnostikimi fillestar dhe orientimi përmes sistemit; 3. Ofrimi i trajnimeve

27 Vendim i Keshillit te Ministrave nr. 173, datë 24.3.2023 'Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024'

28 *Ibid*

29 *Ibid*

30 *Ibid*

mbi aftësitë e buta. OJF-të mund të aplikojnë për secilën nga këto detyra individualisht, bazuar në përvojën dhe burimet që kanë.

Faza e ofertave është faza e fundit e zbatimit të Garancisë Rinore, që bën bashkë programet kryesore për të mbështetur të rinjtë që rihyjnë në arsim dhe formim profesional, apo që bëjnë kalimin në punësim.

Konstatim: Megjithëse në PZGR është parashikuar dhe sugjeruar krijimi i një dinamike vendore - ku angazhohen OJF, bashki, zyra pune vendore dhe partnerë të tjerë e aftë të zhvillojë strategjitë e komunikimit dhe informimit me të rinjtë, në fazën e parë të zbatimit të skemesë së pilotimit në nëntor 2023 në qytetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlores vihet re shmangia e angazhimit të OJF-ve rinorë/për rininë. Aktualisht është vlerësuar të angazhohen vetëm Këshillat Vendorë të Rinisë. Është për tu vlerësuar në vijim niveli i angazhimit për OJF rinore/për rininë në këtë proces.

### **Rekomandim:**

Të realizohen parashikimet e bëra në planin e veprimit të GR-së si vijonë:

- Të hartëzohen (përcaktohen) institucionet vendore duke pasur parasysh Këshillat Vendorë të Rinisë që mund të luajnë rol relevant në zbatimin e strategjisë së komunikimit në ndihmë të zyrave vendore të punës.
- Të hartohet një program forcimi kapacitetesh (trajnim i personelit teknik të organizatave të ndryshme) dhe i burimeve metodologjike (udhëzime, burime informacioni, paketa trajnimesh të shkurtra) që u drejtohen të gjithë llojeve të partnerëve.
- Të zbatohet një skemë grant që synon të mbështetë organizatat rinore mbi zhvillimin e rolit të tyre në strategjinë e komunikimit, kryesisht në dhënien e informacionit dhe trajnimeve për rininë.
- Të përfshihen në mënyrë përfshirëse organizatat rinore/për të rinjtë në fazat e zbatimit të Garancisë Rinorë duke përfshirë edhe fazën e monitorimit.

## 2. KAPITULLI: IMPLEMENTIMI I LIGJIT TE RINISE NE NIVEL LOKAL

Nje nder shtyllat kryesore te monitorimit i eshte kushtuar ecurise se implementimit te Ligjit per Rinine ne nivel lokal, duke marrë si kampion studimi 61 bashkite e vendit. Keto te dhena per here te pare jane gjeneruar pergjate vitit 2021 ne raportin e monitorimit te titulluar "Sfidat dhe Efektet e Zbatimit te Ligjit 75/2019" ku nga 61 bashki, 43 i jane pergjigjur pozitivisht formateve qe jane perdorur ne gjenerimin e te dhenave duke mbuluar keshtu rreth 70% te bashkive ne vendit.

Ne ndryshim nga viti 2021, në vitin 2022 ka patur nje renie ne nivelin e perfshirjes se bashkive pasi nga 61 bashki jane perfshire vetem 34 prej tyre, duke e ulur nivelin e mbulimit ne rreth 56% ne krahasim me 70% qe ishte vitin 2021. Bashkite qe jane perfshire ne studim në vitin 2022 jane bashkia: Pogradec, Berat, Cerrik, Durres, Tirane, Gjirokaster, Gramsh, Kavaje, Klos, Kolonje, Lezhe, Lushnje, Mat, Permet, Rogozhine, Selenice, Shkoder, Skrapar, Vlore, Belsh, Bulqize, Delvine, Fier, Fushe-Arrez, Kamez, Korçe, Kukes, Kuçove, Libohove, Maliq, Mirdite, Perrenjas, Tropoje dhe Finiq.

Në raportin e këtij vitit 2023 janë përgjigjur 35 bashki kërkesës për informacion pra rreth 57% e tyre. Bashkite qe jane perfshire ne studim në vitin 2023 jane bashkia: Bels, Berat, Bulqizë, Devoll, Divjakë, Durres, Fier, Finiq, Gjirokastër, Gramsh, Himarë, Kamëz, Klos, Kuçovë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Peqin, Pogradec, Prrenjas, Puctec, Pukë, Roskovec, Sarandë, Shkoder, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Vau-Dejës, Vlorë, Vorë.

**Parashtrimi i rezultateve të përgjigjeve të përfuara paraqitet në analizën e mëposhtme. Duhet të kihet në konsideratë se përgjigjet e mbledhura nga NJVV-të paraqesin panoramën e situatës deri në qershor të vitit 2023. Si e fillë, është e kuptueshme që ka patur dinamika në realizimin e detyrimeve të ligjit deri në dhjetor 2023 qe ky raport ka mandatin e analizës.**

### 2.1.Përbërja e Këshillit Vendor i Rinise

Pyetja "Nëse Këshilli Vendor i Rinise (KVR) është ngritur, ju lutemi informoni mbi:

- Përbërjen e tij (anëtarësinë përfshirë dhe organizatat qe të rinjtë përfaqësojnë);
- Nëse janë realizuar mbledhje dhe sa të tilla që prej ngritjes së KVR-së."

Numri I bashkive në krahasim me numrin e anëtarëve të KVR	
<i>(tabela nr. 1)</i>	
Bashki	Anëtar
1	4
2	5
13	6
3	7
4	8
2	9
1	13
1	21
1	22
1	26

Përsa i përket përbërjes së Këshillave Vendor te Rinise rezulton se, mesatarisht, ato përbëhen nga 8 anëtarë. Rezultoni se anëtarësia është e përbërë nga përfaqësues ose drejtues të pushtetit lokal, përfaqësues të studentëve (në Bashkitë ku ka shkolla të arsimit të lartë), përfaqësues të nxënësve të gjimnazit, përfaqësues të komuniteteve dhe përfaqësues të organizatave rinore që veprojnë në qytetet përkatëse.

Nëse do të analizojmë numrin e bashkive në krahasim me numrin e anëtarëve të KVR, rezultoni se 13 bashki kanë zgjedhur 6 anëtarë të KVR, ndërsa pjesa tjetër varion, ku numri më i ulët i anëtarëve të zgjedhur është 4, ndërsa numri më i lartë është 26 anëtarë.

Nga përgjigjet e disa Bashkive, të cilat deklarojnë se numri i anëtarëve të KVR është më i lartë se 6, të tilla si Bashkia Peqin, Roskovec, Kamëz arrijmë në përfundimin se disa prej tyre e ngatërrojnë konceptin e përbërjes së Këshillit Vendor Rinor, me numrin e të rinjve të angazhuar, pasi në nenin 10 të ligjit "Për rininë", thuhet se: "Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë."

Por, nga kërkimet që ne kemi bërë në web, rezultoni se edhe pse në pyetësor bashki si Bashkia Peqin kanë raportuar një numër të lartë anëtarësh të KVR, në fakt, në mbështetje të Vendimit nr. 88, datë 09.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Peqin "Për ngritjen e Këshillit Vendor të Rinisë", përbërja e këshillit është konform parashikimeve të ligjit.

Vlen të përmendet se bashkia më e madhe në Republikën e Shqipërisë, Bashkia Tiranë, i është përgjigjur vetëm aspektit financiar të pyetësorit, duke lënë pa përgjigje të gjitha pyetjet në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor, por në faqjen zyrtare web të Ministrisë të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, rezultoni se KVR është ngritur prej muajit qershor 2023 pranë kësaj Bashkie.

## 2.2. REALIZIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT VENDOR TE RINISE

Në periudhën e adresimit të kërkesës për informacion tek NJVV-të, Këshillat Vendor Rinorë ishin ngritur në 33 bashki nga 35 që janë pjesë e studimit. Sipas informacionit të bërë publik dhe në dalje mediatike të Ministrisë Muzhaqi, dy bashkitë e fundit, Bashkia Shkodër dhe Bashkia Vau Dejës i kanë ngritur Këshillat Vendorë rishtazi duke shënjuar dhe ngritjen e KVR-ve në të 61 NJVV-të.

Nga përgjigjet nga 33 Bashkitë, rezultoni se në 28 Bashki janë realizuar mbledhje të KVR, në 2 bashki nuk janë realizuar ende,


ndërsa 3 bashki nuk kanë zgjedhur t'i përgjigjet kësaj pyetje, si (Bashkia Tiranë, Finiq, etj..). Në bashki si Bashkia Vlorë, Pukë edhe pse KVR është ngritur me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të bashkisë, Këshilli Rinor Vendor nuk funksionon, nuk është realizuar asnjë takim dhe asnjë mbledhje. Grafiku nr. 2 shpreh në përqindje statistikën e mësipërme. **Gjithsesi ky informacioni nuk paraqet panoramën e realizimit të mbledhjeve deri në dhjetor 2023. Informacioni i përket periudhës deri në qershor 2023.**



### 2.3. NUMRI I MBLEDHJEVE TË KVR

Në lidhje me numrin konkret të mbledhjeve të realizuara në KVR, indikator i cili tregon angazhimin real të strukturave vendore në ngritjen dhe funksionimin e këtyre strukturave, i janë përgjigjur pyetjes 28 bashki, nga të cilat rezultojnë se janë realizuar 2 mbledhje në 22% të bashkive në studim, pasuar nga 18% të tyre të cilat kanë kryer vetëm 1 mbledhje, ndërsa 14% nuk e kanë specifikuar numrin e mbledhjeve.

Numrin më të lartë të mbledhjeve të KVR e ka raportuar Bashkia Gjirokastrë, me 6 mbledhje në total, duke marrë parasysh që ky Këshill ka vetëm 1 vit që është ngritur, sipas informacioneve të marra nga faqja Eeb e Bashkisë.



### 2.4. PAJISJA ME DOKUMENT STRATEGJIK PËR RININË

Pyetja "Neni 7, pika 1/c parashikon organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendorë në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve. Në këtë kuadër:

- 'Në bashkinë tuaj a ka dokument lokal strategjik për rininë?'

Si indikator që tregon qartë angazhimin e pushtetit lokal në konkretizimin e ligjit "Për rininë", është vlerësuar edhe hartimi i dokumentit strategjik vendor për rininë. Kësaj pyetje i janë përgjigjur 31 nga 35 bashki të angazhuara në pyetësor dhe rezultojnë se 74% e Bashkive nuk e kanë hartuar ende një dokument strategjik për rininë, ndërsa vetëm 26% shprehen se e kanë një të tillë. Rezultatet e këtij indikator paraqiten në grafikun nr. 4.

Kemi vlerësuar se nëse Bashkitë e kanë një dokument strategjik për rininë, është i një rëndësie thelbësore publikimi i tij në faqjen zyrtare web të tyre, për ta bërë më të aksesueshëm nga qytetarët dhe grupet e interesit. Nga Bashkitë që e kanë tashmë këtë dokument, vetëm 2 prej tyre e kanë publikuar në faqjen eeb (Bashkia Gramsh dhe Kamëz). Nga kërkimi në faqjen eeb, rezultoi se Bashkia Gramsh e ka realizuar këtë detyrim, duke punlikuar "Dokument orientues për përfshirjen e rinisë në planet lokale" dhe Bashkia Kamëz ka publikuar "Plani lokal i veprimit për rininë 2020-2023".



Gjithashtu, pyetjes nëse është në planin e Bashkisë për të hartuar një dokument strategjik për rininë, të gjitha Bashkitë i janë përgjigjur se po punojnë për hartimin e tij, disa prej tyre të asistuar në këtë detyrë nga organizata.



## 2.5. PËRFSHIRJA NË PROJEKT-BUXHET E ZËRAVE TË DEDIKUAR PËR RININË.

Pyetja "Neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta.

- Në PBA aktuale a ka zë/zëra të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj?
- Nëse po ju lutem specifikoni programin buxhetor përkatës në PBA 2023-2025."

Mbështetja financiare nga ana e pushtetit lokal ngritjes dhe funksionimit të strukturave për rininë, është faktor ndikues në vazhdimësinë e suksesshme të këtyre strukturave.

Pyetjes "Në PBA aktuale, a ka zë/zëra të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj?" rezulton se 44% e 35 Bashkive që janë përgjigjur, nuk e kanë përfshirë, si Bashkia Lezhë, Devoll, Peqin, Fier etj, 53% e kanë përfshire, si Bashkia Kucove, Roskovec, Gramsh, Prrenjas, Klos (vetëm 9 prej tyre e kanë specifikuar zërin) në PBA aktuale dhe 3% nuk e kanë specifikuar.

Përsa i përket parashikimit të zërit të dedikuar për rininë në PBA viti 2023-2025, nga përgjigjet e marra rezulton se 50% e Bashkive të angazhuara në pyetësor e kanë përfshirë zërin për rininë në projekt buxhet, si Bashkia Kamëz, Mallakastër, Tepelenë etj., 44% e tyre nuk e kanë përfshirë, ndërsa 6% nuk e ka specifikuar.


## 2.6. MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE RAPORTIMI I TË DHËNAVE PËR SITUATËN E TË DREJTAVE TË TË RINJVE NË TERRITORIN E BASHKIVE.

Mbledhja, analizimi dhe raportimi i të dhënave për situatën e të drejtave të të rinjve është një detyrim ligjor, i cil i krijon pasqyrën e saktë dhe reale të situatës të së drejtave të të rinjve, duke matur kështu edhe efektivitetin e këtyre strukturave.

Në grafikun nr. 7, janë paraqitur statistikat e përgjigjeve të Bashkive mbi këtë detyrim. Rezultoni se vetëm 35% e tyre e realizojnë detyrimin e mbledhjes, analizimit dhe raportimit të të dhënave, ku bashki si Bashkia Himarë kanë realizuar në bashkëpunim me anëtarët e KVR anketime për përdorimin e teknologjisë dhe ndikimin e saj tek të rinjtë e qytetit dhe i kanë përpunuar këto të dhëna për të dalë në disa përfundime.

Më tej, 56% e tyre nuk e realizon, ndërsa 9% kanë zgjedhur të mos i përgjigjen kësaj pyetje.


Në specifikimet përshkruese që kanë bërë disa prej Bashkive të angazhuara në pyetësor, rezultoni se këtë detyrim ligjor këto institucione e kryejnë në bashkëpunim me organizata jofitimprurëse me fokus rininë, me Zyrën Vendore Arsimore ose me AKR.



## 2.7. NDËRTIMI I DATABASËS SË TË DHËNAVE.

Qëllimi i bazës së të dhënave për rininë është të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor.


Realizimi efektiv i përgjegjësiave dhe detyrave të strukturave rinore të ngritura me ligj, ndikohet ndjeshëm edhe nga bashkëpunimi i herëpashershëm me organizatat jo fitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në territorin e secilës Bashki. Thënë kjo, shkëmbimi i eksperiencave, organizimi dhe pjesëmarrja e aktiviteteve të përbashkëta, bashkimi i fuqive dhe ideve për mbrojtjen dhe fuqizimin e të drejtave të të rinjve realizohet më mirë duke bashkëpunuar dhe duke pasur kontakt të vazhdueshëm me OJF, prandaj, ndërtimi i një database të të dhënave të OJF me objekt të rinjtë, lehtëson dhe organizon punën e strukturave të rinisë të ngritura me ligj pranë pushtetit lokal. Në lidhje me këtë detyrë, 63% e Bashkive të angazhuara në pyetësor janë shprehur se nuk e kanë ngritur ende një database me këto të dhëna, 34% e tyre e kanë ngritur këtë database, ndërsa 3% nuk e kanë specifikuar kryerjen ose jo të kësaj detyre.



## 2.8. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE.

Bashkëpunimi i Bashkive me organizatat e shoqërisë civile për të rinjtë, të cilat janë të ngritura sipas ligjit dhe kanë për qëllim përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse rezultojnë shumësisht të suksesshëm. Pothuaj të gjitha këto institucione kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me këto organizata (82% e tyre e kanë konfirmuar bashkëpunimin) ndërsa një përqindje e vogël e Bashkive (18% e tyre), si Bashkia Finiq, është shprehur se nuk ka bashkëpunim, pasi janë Bashki me shtrirje territoriale të vogël dhe numër të vogël popullësie, në territorin e së cilave nuk vepron asnjë organizatë me objekt të saj rininë.

Bashkëpunimi me organizatat rezultojnë frytshëm në pjesën dërrmuese të Bashkive ku është vendosur ky bashkëpunim, pra 96% e tyre janë shprehur pozitivisht për të, ndërsa 4% e tyre vlerësojnë se ka nevojë për përmirësim dhe forcim të mëtejshëm të bashkëpunimit midis këtyre strukturave.



## 2.9. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË TË RINJVE SHQIPTAR NË DIASPORË.

Ligji 75/2019 "Për rininë" në nenin 2 të tij shpreh si qëllim kryesor edhe mbrojtjen e promovimin e të drejtave të të rinjve në diasporë. Kontaktet dhe bashkëpunimin faktik me organizatat e të rinjve shqiptar në diasporë, rezulton se e kanë ngritur vetëm një numër i vogël i Bashkive të angazhuara në proces, vetëm 10% e tyre deklarojnë se bashkëpunimi është vendosur (të tilla si Bashkia Pogradec, Kukës, Berat), ndërsa 84% e tyre janë shprehur se nuk ka ende bashkëpunim ndërkufitar.




## 2.10. ANGAZHIMI PËR MASAT SKR-SË 2022-2029

Nga përpunimi i të dhënave të përftuara nga kërkesa për informacion, rezulton se 53% e Bashkive janë të angazhuara aktualisht në realizimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029, 41% e tyre nuk e kanë nisur këtë angazhim, ndërsa 6% nuk e kanë specifikuar.

Në përgjigjet përshkruese mbi realizimin e masave të parashikuara në SKR 2022-2029, përgjithësisht Bashkitë janë shprehur se janë në proces të

realizimit të masave, në proces të hartimit të planeve lokale, projekteve, të ndihmuar në këtë detyrë edhe nga organizatat e shoqërisë civile.



## 2.11. STRUKTURAT ADMINISTRATIVE PËR ÇËSHTJET E RINISË.

Pyetja "Neni 7, pika 1/e, parashikon krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë.

- A ka një strukturë administrative për çështjet e rinisë në organikën e aparatit të bashkisë suaj?"

Ngritja e strukturës për çështjet e rinisë në organikën e secilës Bashki ka rëndësi thelbësore në funksionimin e strukturave rinore.

Në 91% të Bashkive në të cilat ekziston struktura administrative për çështjet e rinisë, struktura/personi përgjegjës mbulon edhe çështje të tjera përveç atyre të rinisë, pra ka edhe përgjegjësi të tjera funksionale, të tilla si Bashkia Gjirokastrë, Vlorë, Fier, Pukë, Divjakë. Vetëm në 9% të Bashkive ku janë ngritur strukturat, personi përgjegjës ka si detyrë vetëm mbulimin e çështjeve rinore, të tilla si Bashkia Vorë, Himarë, Pogradec.

## PERFUNDIME

### **Konstatime:**

- Informacioni publik i Bashkive për koordinatorin e të drejtës së informimit, apo personit përgjegjës mungon, është i cunguar, ose është i vjetëruar, jo i rifreskuar;
- Një pjesë e konsiderueshme e Bashkive të Shqipërisë (42 %) nuk kthejnë përgjigje sipas kërkesave të të drejtës për informacion, edhe pas formave të ndryshme të kontaktimit me email, numër telefoni, dhënia e informacionit mungon;
- Mos pasja e një dokumenti strategjik për rininë, që shërben si udhërrëfyes për punën e mëtejshme të këtyre institucioneve me këtë audiencë, më saktësisht 74% e Bashkive të pyetura nuk e kanë hartuar ende një dokument strategjik për rininë, është një tregues i rëndësishëm e mungesës së vizionit lokal për Rininë, e një plani të mirë strategjik afatgjat;
- Mungesa e një dokumenti strategjik afekton dhe planin buxhetor që Bashkitë ndërmarrin për sektorin e Rinisë, si dhe analizën e të drejtave, kërkesave, sfidave lokale, e adresimin e tyre efikas.
- Për sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile, në rreth 50% të Bashkive të përgjigjura, ekziston një databazë e organizatave, ndërkohë mbi 90% e tyre tregojnë se kanë një bashkëpunim të frytshëm me shoqërinë civile në qytet. Nuk mund të raportohet e njëjta gjë për organizatat lokale të diasporës mbi të cilat ka pak, ose aspak informacion dhe bashkëpunim.
- Në tërësi ka një njohje të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, si dhe angazhimeve të ndërmarrara, si dhe janë ngritur struktura rinore që kanë në kompetencat e tyre incentivat rinore, por vetëm në 9 % të rasteve këto struktura janë të dedikuara vetëm për çështjet rinore, por mbulojnë dhe të tjera kompetenca.

### **Rekomandime**

- Bashkitë duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje përditësimit të faqeve të tyre zyrtare web me informacione dhe dokumente strategjike për rininë, si mënyra më e shpejtë dhe më e aksesueshme e këtyre informacioneve nga publiku i gjerë dhe grupet e interesit.
- Duhet të rifreskohen periodikisht kontaktet e personave përgjegjës për të drejtën e informimit të shpallura publikisht, pasi çënojnë të drejtën ligjore të informimit
- Strukturat administrative për çështjet e rinisë në organikën e Bashkive është mirë që të jenë të dedikuara vetëm për këtë kompetencë.
- Duhet të ketë konsultim me të rinjtë, organizata rinore dhe grupe jo formale për të krijuar një tablo të grupeve aktive në secilin qytet, shoqëruar me vleresim nevojash, si dhe analizë situatë.
- Angazhim permbajtësor i strukturave lokale të këshillave vendor të rinisë, organizatave të shoqërisë civile dhe drejtorisë përgjegjëse në hartimin e një strategjie dhe plani veprimi, si udhërrëfyes për ngritjen e prioriteteve dhe adresimin e buxhetit vendor për rininë.


### 3. KAPITULLI: PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE/PËR TË RINJTË PËR ZBATIMIN E LIGJIT 75/2019 “PËR RININË”

Kongresi Rinor Kombetar ka hartuar një pyetësor on line adresuar Organizatave të Shoqërisë Civile, konkretisht atyre rinore/për rininë sipas ligjit 75/2019 me qëllim matjen e perceptimit të tyre mbi nivelin e implementimit të ligjit duke arritur në konkluzione mbi perceptimin nëse dispozitat e ligjit po përkthehen në mënyrë efektive apo masa të zbatueshme në dobi të të rinjve. Në analizën si vijon referohen gjetjet dhe rekomandimet të përcjella nga 34 OSHC që morën pjesë në pyetësor.

#### 3.1. NIVELI I INFORMIMIT DHE PERCEPTIMIT MBI ZBATIMIN E PËRGJITHSHËM TË LIGJIT 75/2019 DHE SKR


Të anketuarit janë pyetur lidhur me nivelin e familjarizimit me ligjin dhe perceptimin mbi nivelin e përgjithshëm të zbatimit të tij. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve deklarojnë se janë **shumë të familjarizuar** (58.6%) me përmbajtjen e ligjit për rininë, që është thelbësore për avokimin mbi zbatimin e tij. Grupi tjetër më i lartë përbëhet nga ata që janë **disi të familjarizuar** (31.0%). Ndërkaq një grup më i vogël ka deklaruar **se është aspak i njohur** (10.3%) me ligjin, duke treguar se ka ende një boshllëk njohurie midis organizatave rinore.

Sa i/e familjarizuar je me përmbajtjen e ligjit ‘Për rininë’?



Për sa i përket pyetjes mbi vlerësimin e **ecurisë së zbatimit të Ligjit ‘Për Rininë’ në përgjithësi**, përgjigja mbizotëruese (38.5 %) është **‘zbatim i ulët’**. Një grup më i vogël (30.8%) mendojnë se ka ecuri zbatimi **në nivel mesatar**. Ndërkohë, 23.1% e tyre mendojnë se ka nivel zbatimi shumë të mirë. Është dukshëm kontrasti në perceptim midis përfaqësuesve të organizatave c’ka mund të jetë për shkak të ndryshimeve në përvoja.


Si do ta vlerësonit ecurinë e zbatimit të ligjit ‘Për rininë’ në përgjithësi?



**Të anketuarit janë pyetur nëse mendojnë se miratimi i këtij ligji ka ndikuar pozitivisht në jetën e të rinjve duke synuar të hetohet drejtpërdrejt mbi perceptimet e të anketuarve për ndikimin e prekshëm të ligjit në jetën e të rinjve. Shumica e të anketuarve, 42.3%, mendojnë se miratimi i ligjit ka pasur **disi** ndikim pozitiv në jetën e të rinjve dhe 23,1% e të anketuarve mendojnë se **ka patur ndjeshëm ndikim pozitiv**. Ndërkaq ka ende një pjesë të dukshme të të anketuarve që janë të pavendosur ose neutralë (" **As po, as jo**" (19.2%) ) për ndikimin e ligjit si dhe një segment më i vogël i cili beson se ligji **nuk ka pasur ndikim pozitiv** (" **Jo**" (7.7%) ).**

KRK ka synuar të masë dhe perceptimet e të anketuarve lidhur me ndikimin e zhvillimeve të fundit politike në sektorin e rinisë për të kuptuar nëse ndryshimet politike gjatë tre viteve të fundit kanë

A mendoni se miratimi i këtij ligji (nëpërmjet parashikimeve të tij) ka ndikuar pozitivisht në jetën e të rinjve?  
26 responses




pasur një ndikim pozitiv apo negativ në organizatat rinore dhe të rinjtë në shoqëri. 57.7% e tyre shprehen se **'e kanë përmirësuar'** dhe 3.8% e tyre perceptojnë se e kanë **'përmirësuar disi'**. Kjo tregon se disa organizata mund të kenë patur përfitime ose ndryshime pozitive në veprimtarinë e tyre ose në mjedisin e përgjithshëm për të rinjtë.

Gjithsesi, një pjesë po ashtu e konsiderueshme, 30.8%, mendojnë se zhvillimet politike në 3 vitet e fundit **nuk kanë çuar në ndonjë ndryshim** të rëndësishëm në sektorin e rinisë qoftë pozitiv apo negativ. Një grup më i vogël prej 3.8% mendon se situata për organizatat rinore dhe të rinjtë **është përkeqësuar** për shkak të zhvillimeve politike dhe po aq shprehen se nuk kanë mendim për këtë çështje.

**Të anketuarit janë pyetur dhe mbi nivelin e familjarizimit me masat e planifikuara nga Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029.** Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është institucioni koordinues

Në gjykimin tuaj, zhvillimet politike në 3 vitet e fundit në sektorin rinor e kanë përmirësuar apo përkeqësuar situatën e organizatave rinore/për te rinjtë në shoqëri?  
26 responses




për zbatimin e **Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029 i cili është dokumenti bazë për koordinimin e politikave në sektorin rinor**. 53,8% ka konfirmuar se janë **shumë të familjarizuar** dhe 38.5% e të anketuarve tregojnë se janë **disi të familjarizuar**. Një përqindje e vogël kanë deklaruar se janë **aspak të familjarizuar** (7.7%) duke qenë në koherencë pak a shume me nivelin e përgjigjeve mbi njohjen e ligjit për rininë. Këto të dhëna tregojnë për ndërëgjegjësim të përgjithshëm pozitiv. Gjithsesi është e nevojshme dhe angazhim më i thelluar i organizatave në njohjen me strategjinë si

dhe pasja e strategjive më të mira të komunikimit nga institucionet përgjegjëse për të siguruar që organizatat rinore të jenë të informuara.

### Sa i familjarizuar jeni me masat që planifikon Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029?

26 responses




Shumica dërrmuese e të anketuarve (92.3%) besojnë se **ekzistenca e një dokumenti strategjik për rininë i shërben organizatave rinore për të adresuar më mirë problematikat e të rinjve dhe për të gjetur zgjidhje konkrete**. Ky është një tregues se sektori i të rinjve i kushton rëndësi planifikimit të strukturuar strategjik. Dokumente të tilla duhet parimisht të shërbejnë edhe si korniza udhëzuese, duke ndihmuar organizatat në përpjekjet e tyre për të mbrojtur kauzat e të rinjve.

### Komente dhe rekomandime mbi zbatimin e përgjithshëm të ligjit 75/2019 dhe SKR

Pyetur nëse ligji ka nevojë për tu ndryshuar/amenduar një numër i konsiderueshëm i të anketuarve 38.5%, mendojnë se ligji kërkon ndryshime apo amendime dhe 11.5% që shprehen 'as po as jo' duke mos patur qartësinë konkrete për ndërhyrje. Ndërkohë vetëm një segment i vogël i të anketuarve 15.4% mendojnë se ligji aktual nuk kërkon ndonjë ndryshim apo amendim. Për tu theksuar është dhe përqindja e përfaqësuesve e lartë (34.6%) të organizatave të cilat kanë zgjedhur alternativën 'nuk kam mendim për këtë çështje' ndërkohë që ky është ligji kuadër që synon të rregullojë sektorin e rinisë.

### A mendoni se Ligji 'Për rininë' ka nevojë për tu ndryshuar/amenduar?

26 responses



Disa nga çështjet që sillen në vemendje për tu ri-adresuar/amenduar në ligjin për rininë janë si më poshtë:

- Përcaktimi i moshës së të rinjve nga 29 në 35 vjeç.
- Rishikim i rolit të kryetarit të bashkisë si kryetar i KVR-së. Arsyeja është se kryetari i bashkisë ka përgjegjësi të shumta dhe dikush tjetër nga Bashkia mund të jetë më i përshtatshëm për këtë rol.
- Rritja e kompetencave të KVR-së nga organ thjesht konsultativ në kompetenca dhe vendimmarrëse.
- Rishikim i detyrave dhe përgjegjësi të Organizatës Përfaqësuese të Rinisë.

- Rregullim i mëtejshëm dhe njohje e punës rinore dhe punonjësve rinorë.

Si më poshtë janë disa nga parashikimet/ dispozitat e ligjit që të anketuarit besojnë **se janë zbatuar me sukses**:

- Ngritja e Këshillave Vendore te Rinise;
- Themelimi dhe funksionimi i AKR-së;
- Shtimi i projekteve për përfshirjen e të rinjve;

### 3.2. PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE PER IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TE RINISE NE NIVEL QENDROR

#### **Ministria përgjegjëse për rininë dhe Strategjia Kombëtare për Rininë**

**Të anketuarit janë pyetur nëse mendojnë se ka transparencë në monitorimin dhe vlerësimin e ligjit nga Ministria përgjegjëse për Rininë.** Të kuptuarit e perceptimeve mbi nivelin e transparencës është thelbësore pasi ajo ndikon drejtpërdrejt në besimin e organizatave në sistem dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar, për të dhënë komente dhe për të marrë pjesë aktive në proceset e politikëbërjes ose vlerësimit. **“Nuk kam informacion nëse realizohet një vlerësim/monitorim i tillë”** janë shprehur 38.5% e të anketuarve. **‘Ka disi transparencë dhe ka informacion disi të aksesueshëm’** janë përgjigjur 30.8% e të anketuarve dhe vetëm 23.1% e tyre mendon se ka transparencë dhe informacioni është i aksesueshëm ndërkohë që 7.7 % e tyre shprehen se **‘Nuk ka transparencë dhe nuk ka informacion të aksesueshëm’**.

Mendoni se ka transparencë në monitorimin dhe vlerësimin e ligjit 'Për rininë' nga Ministria përgjegjëse për rininë?

26 responses



**Komente dhe rekomandime** për Ministrinë përgjegjëse për rininë dhe Strategjia Kombëtare për Rininë

Si vijon gjendet një përmbledhje komentesh/sugjerimesh të të anketuarve për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në lidhje me zbatimin e ligjit 75/2019:

- Të sigurojë trajnim të anëtarëve të KVR-ve duke siguruar shtrirje gjeografike të barabartë dhe të monitorojë veprimtaritë e tyre për një angazhim sa më përmbajtësor.
- Të bashkëpunojë me organizatat rinore për të identifikuar problemet që ato kanë identifikuar gjatë monitorimit të Ligjit 'Për Rininë' për përmirësimin e ligjit.



- Të ngrihet Organizata Rinore Përfaqesuese duke e përmirësuar kuadrin ligjor për këtë organizëm.
- Më shumë fokus tek të rinjtë e qyteteve të vogla dhe ata në zona rurale.
- Të jenë me afër organizatave rinore dhe për të rinjtë; të ketë transparencë; të organizojë sa me shume takime këshillimore me organizatat rinore dhe ofrimin e iniciativave konkrete për edukimin jo-formal.
- Të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për të krijuar ura lidhëse lidhur me informimin e të rinjve në zona urale.
- Të ndikojë tek të zgjedhurit vendorë që të krijojnë hapësira si për organizata rinore ashtu edhe për të rinjtë aktivë dhe KVR.
- Të monitorojë sa % në buxhetin e Bashkive alokohen për aktivitete rinore ose i dedikohen sektorit/drejtorise së rinisë.
- Të ndiqet zbatimi i SKR-së me plane veprimi lokale të hartuara sipas nevojave dhe të buxhetuara sipas vitve në vazhdim.


### Agjencia Kombëtare për Rininë

**Agjencia Kombëtare për Rininë është një nga** institucionet e ngritura me ligjin për rininë me ndikim në sektorin rinor. Për 38.5%, kjo veprimtari e ka **'përmirësuar disi'** dhe për 26.9% e tyre **e ka përmirësuar ndjeshëm** sektorin rinor. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve mendojnë se aktivitetet e AKR-së **kanë pasur një ndikim kryesisht pozitiv**. Këto rezultate janë inkurajuese pasi tregojnë se shumë organizata i shohin përpjekjet e Agjencisë të përkthehen në përfitime ose përmirësime të prekshme në sektorin e rinisë.

Një numër i konsiderueshëm po ashtu i të anketuarve (19.2%) mendojnë se veprimtaria e AKR nuk **ka çuar në ndonjë ndryshim të dukshëm në sektorin e rinisë**. Kjo mund të lerë hapësirë interpretimi se, ndërsa Agjencia mund të jetë aktive, iniciativat ose veprimet e saj mund të mos vëzhgohen ose ndjehen drejtpërdrejt nga të gjitha organizatat pjesëmarrëse. Reagimet nga anketa tregojnë **se asnjë organizatë** nuk beson se situata është përkeqësuar për shkak të aktiviteteve të Agjencisë duke qenë tregues pozitiv.

Sipas perceptimit tuaj si ka ndikuar në sektorin rinor veprimtaria e Agjencisë Kombëtare për Rininë?

26 responses



**50% e organizatave kanë pohuar se kanë aplikuar në thirrjet për projekt propozime të shpallura nga AKR.** Kjo tregon një nivel të balancuar të angazhimit dhe interesimit për të bashkëpunuar me AKR-në. Të dhënat sugjerojnë se iniciativat dhe thirrjet e AKR-së po arrijnë një pjesë të mirë të organizatave rinore, duke çuar në pjesëmarrje aktive.

Një përqindje pak më e vogël e të anketuarve (42.3%) **nuk kanë aplikuar** në thirrjet e AKR-së dhe një segment i vogël i organizatave (7.7%) janë shprehur se **nuk janë në dijeni** për thirrjet e AKR-së për projekt propozime. Kuptueshmëri më e thellë e arsyeve të tyre mund të ndihmojë në përmirësimin e strategjive të komunikimi dhe shpërndarjes së informacionit për të siguruar që të gjithë aktorët e mundshëm janë të informuar, dhe bërjen e thirrjeve të ardhshme më gjithëpërfshirëse.


Organizatave të cilat kanë deklaruar se kishin aplikuar në thirrjet e AKR-së për projekt propozime janë pyetur mbi nivelin e kënaqësisë në lidhje me procesin e menaxhimit të këtyre thirrjeve. Duke vlerësuar përvojat e tyre, mund të identifikohen pikat e forta dhe fushat e përmirësimit në menaxhimin e

projekt-propozimeve të AKR-së.

37.5% e organizatave shprehen se procesi i menaxhimit të këtyre thirrjeve ka qenë **i nivelit mesatar**. Për 31.3 % të të anketuarve procesi i menaxhimit **ka qenë shumë i mirë** duke treguar një nivel të lartë të kënaqësisë me procesin e menaxhimit të thirrjeve për projekt propozime nga AKR. Ndërkaq vetëm një nga organizatat (6.3%) shprehet se ka **hasuar menaxhim të nivelit të ulët** që tregon për përvojë negative me procesin.

Gjithsesi, trendi i përgjithshëm duket pozitiv dhe inkurajues, duke sugjeruar që procesi i menaxhimit të thirrjeve për projekt propozime të AKR-së është kryesisht efektiv dhe i mirëpritur nga organizatat. Megjithatë, të kuptuarit e shqetësimeve ose sugjerimeve specifike të atyre që e vlerësojnë atë si mesatare ndihmon në përmirësim të mëtejshëm të procesit.

Nëse po, si do ta vlerësonit procesin e menaxhimit të thirrjeve për projektide që janë lançuar deri më tani nga AKR?  
16 responses



### **Komente dhe rekomandime për Agjencinë Kombëtare për Rininë**


- Të jetë më transparente, sigurojë informimin mbi projektet, ndarjen e fondeve dhe të përmirësojë shpërndarjen e fondeve gjeografikisht.
- Të zgjerohet fusha e veprimtarisë së agjencisë.
- Të bëje publike histori suksesi të projekteve të mbështetura dhe të motivoje organizatat e vogla që të nxisin ndryshimin në komunitetet e tyre.
- Të mos perjashtojë grupet informale dhe të rinjte në thirrjet për projekt ide, vetëm se nuk përfaqësohen nga organizata.
- Të mos jetë detyrim regjistrimi i organizatës në këtë institucion publik si kusht për të përfituar fonde. Mjafton që organizata është e regjistruar në gjykatë sipas ligjeve në fuqi.
- Te rrisë vizibilitetin dhe të njohë më mirë situatën e të rinjve.

### **Këshilli Kombëtar i Rinisë**

Një nga instancat e parashikuar në ligj është dhe ngritja e Këshillit Kombëtar të Rinisë pranë Ministrisë përgjegjëse për rininë. Janë pyetur të anketuarit lidhur me perceptimin e tyre mbi ndikimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Rinisë në sektorin rinor. 46.2% shprehen ekzistenca e këtij Këshilli **'ka ndikuar pozitivisht'** dhe 3.8% shprehen se ka **'ka ndikuar disi'**. Në terma të përgjithshëm, shumica e të anketuarve besojnë se aktivitetet e Këshillit Kombëtar Rinor kanë pasur një ndikim pozitiv në sektorin rinor. Gjithsesi, grupi i dytë më i madh i të anketuarve (23.1%) mendon se veprimtaria e Këshillit **'nuk ka patur asnjë impakt'**. Ndërsa ata nuk shohin një ndikim negativ, perceptimi i mungesës së ndikimit mund të tregojë një shkëputje të mundshme ose hapësirë për përmirësim në veprimtarinë ose iniciativat e Këshillit. Është një përqaqindje e konsiderueshme (19.2%) që janë shprehur se **nuk kanë informacion për veprimtarinë e këtij Këshilli**. Ky është tregues i mungesës së informacionit apo të një hendeku informacioni ndërmjet Këshillit dhe segmenteve të caktuara të sektorit të rinisë. Adresimi i këtij hendeku mund të ndihmojë në përmirësimin e vizibilitetit të veprimtarisë dhe impaktit që ka ngritja e këtij Këshilli.

### Në perceptimin tuaj si ka ndikuar veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Rinisë në sektorin rinor?

26 responses



### Komente dhe rekomandime mbi Këshillin Kombëtar të Rinisë


- Të forcojë më shumë neteorkun dhe të ketë konsultime me të gjera në marrjen e vendimeve.
- Të jetë më prezent dhe jo vetëm aktiv në tryeza diskutimi në nivel qendror.
- Të jetë më transparent lidhur me anëtarët, veprimtarinë dhe si bashkëpunojnë me anëtarët e Këshillave Vendor te Rinise, duke krijuar plane të përbashkëta pune.
- Përbërja e Keshillit Kombetar të Rinisë të ketë përfaqësim gjeografik.

### 3.3.PERCEPTIMI I ORGANIZATAVE RINORE PER IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TE RINISE NE NIVEL LOKAL

Një numër i barabartë i të anketuarve pra 38.5% besojnë se Bashkitë e tyre përkatëse kanë **përbushur me sukses** përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Rininë dhe po aq ato që janë deklaruar **'as po as jo'**. Këta të fundit tregojnë neutralitet apo pasiguri për performancën e bashkisë së tyre në përbushjen e përgjegjësive të Ligjit për Rininë. Një segment më i vogël i të anketuarve, 15.4%, mendojnë se Bashkitë e tyre **nuk i kanë përbushur** me sukses përgjegjësitë që rrjedhin nga ligji.

### A mendoni se Bashkia ku vepron organizata juaj i ka realizuar suksesshëm përgjegjësitë që e ngarkon Ligji 'Për rininë'?

26 responses



Neni 10 i Ligjit 75/2019 "Per Rinine" parashikon ngritjen e disa mekanizmave rinor ne nivel lokal siç janë Keshillat Vendor te Rinise. Shumica dërrmuese e të anketuarve (65.4%) besojnë se ekzistenca e KVR-ve **e përmirëson rolin dhe pozitën e të rinjve në nivel lokal**. Një pjesë e të anketuarve (11.5%) nuk e shohin vlerën apo ndikimin pozitiv të tyre. Ndërkohë këtij perceptimi mund ti shtohen edhe 4 organizata të cilat kanë komentuar lidhur me ndikimin e tyre duke i konsideruar KVR si jo eficiente, pa plane dhe rezultate konkrete, dhe shohin nevojën për të qenë më funksionale.

Një tjetër detyrim i bashkisë është dhe ngritja e strukturave përgjegjëse për rininë. Një shumicë e dukshme e të anketuarve 73.1% konfirmojnë **dijeninë** se në Bashkitë e tyre ka një specialist ose person përgjegjës për çështjet e rinisë. Ky është një tregues pozitiv, duke sugjeruar që shumë qeveri vendore e njohin rëndësinë e të pasurit të personelit të përkushtuar për të trajtuar çështjet që lidhen me të rinjtë, duke siguruar përfaqësim më të mirë dhe angazhim më efektiv.

Një segment i të anketuarve (23.1%) është i pasigurt për praninë e një specialisti të caktuar për të rinjtë në Bashkitë e tyre. Ky mund të jetë tregues për hendekun e mundshëm në komunikim midis organizatave dhe strukturave rinore në bashki si dhe nënvizon rëndësinë e komunikimit proaktiv nga Bashkitë për të mbajtur të informuar organizatat rinore.

Gjithashtu shumica e të anketuarve (61.5%) deklarojnë se organizatat e tyre **janë angazhuar** me specialistin ose personin përgjegjës për rininë në Bashkitë e tyre të paktën një herë kundrejt atyre që deklarojnë të kundërtën (11.5%). Ky është tregues pozitiv lidhur me komunikimin dhe bashkëpunim aktiv ndërmjet organizatave rinore dhe përfaqësuesve të caktuar Bashkiakë por me nevojë për të rritur më tej bashkëpunimin.

Një nga çështjet që duket se ka pothuajse qëndrim unanim është mendimi **se organizatat/rrjetet rinore mund të vijnë në ndihmë në mirëfunksionimin e ligjit të rinisë në nivel lokal**. Përfshirja e tyre shihet si thelbësore për avokimin, përfaqësimin dhe bashkëpunimin efektiv me autoritetet vendore. Përfshirja dhe bashkëpunimi i tyre proaktiv mund të nxisë rezultate më të mira për politikën dhe nismat me në qendër rininë.

#### **Komente dhe sugjerime për Bashkitë**

- Të jetë transparente në të gjitha fazat e krijimit të KRV-së.
- Të alokojë fonde dedikuar të rinjve.
- Të krijojë hapësira për rininë duke u ofruar hapësira fizike OJF-ve që të përfshihen të rinjtë në iniciativa
- Të emerojnë specialiste **të dedikuar për rininë në strukturë**.

#### **Komente dhe sugjerime për Këshillin Vendor të Rinisë (sipas bashkive)**

- Të rishikohet përbërja e tij sipas ligjit.
- Të hartohet plani afatshkurter dhe afatgjatë i KVR-së dhe të jetë transparent/ i aksesueshëm nga të rinjtë.
- Të jetë kërkues/lobues në Këshillin Bashkiak për të alokuar fonde dedikuar të rinjve.
- Të jetë aktiv dhe jo vetëm strukturë formale.
- Të ketë në përbërje të rinj aktiv në komunitet dhe të pa varur nga partitë politike.
- Te bashkëpunojë me grupe të ndryshme rinore lokale.
- Të jetë zë për të gjithë të rinjtë, duke qenë aktiv, i hapur për të degjuar.

## **PËRFUNDIME**

Pyetëtori kishte për qëllim mbledhjen e njohurive mbi perceptimin e organizatave rinore në lidhje me zbatimin e ligjit 75/2019 "Për Rininë". Duke mbledhur përgjigje nga organizata të ndryshme pyetëtori synoi vlerësimin e ndikimit të ligjit, identifikimin e fushave për përmirësim dhe të kuptonte sfidat me të cilat përballëshin gjatë zbatimit të tij.

- Shumica e organizatave rinore janë të njohura me përmbajtjen e ligjit, duke treguar rëndësinë e tij në sektorin e rinisë. Megjithatë, një 'zhytje' më e thellë në agregimin e të dhënave të pyetësit tregon për nivele të ndryshme familjariteti bazuar në bashki të ndryshme, duke treguar boshllëqe të mundshme komunikimi në rajone të caktuara.

- Shumica e organizatave e perceptojnë zbatimin e ligjit vetëm si "pjesërisht të suksesshëm". Kjo nxjerr në pah nevojën për vlerësim dhe përshtatje të vazhdueshme për të siguruar që objektivat e ligjit janë realizuar plotësisht.

- Shumica besojnë se ligji ka pasur një ndikim pozitiv në jetën e të rinjve. Megjithatë, kjo ndjenjë ndryshonte në bazë të bashkive, duke sugjeruar suksese të ndryshme zbatimi nëpër rajone.

- Të anketuarit shfaqën ndjenja të përziera në lidhje me ndikimin e zhvillimeve politike në sektorin e rinisë në tre vitet e fundit.

- Një numër i konsiderueshëm organizatash mendojnë se ka mungesë transparence në monitorimin dhe vlerësimin e ligjit nga ministria përgjegjëse.

- Ekziston një perceptim i ndryshëm për Bashkitë që përmbushin përgjegjësitë e tyre sipas ligjit. Disa besojnë në rolin pozitiv të Këshillave Vendorë të Rinisë, por të dhënat tregojnë një dëshirë për angazhim më proaktiv, planifikim transparent dhe pavarësi politike në nivel lokal.

## 4. KAPITULLI: PERCEPTIMI I TE RINJVE MBI IMPLEMENTIMIN E LIGJIT 75/2019 “PER RININE”

Mbledhja e te dhenave qe jane paraqitur ne kete kapitull, eshte bere nepermjet nje pyetesori online dhe perfshine 103 të anketuar ku 95 % e tyre janë 15-29 vjeç dhe jetojne ne 12 qarqet e Shqiperise. 30.61% e të anketuarve kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve, çka tregon se janë me diplomë Bachelor. Ky është niveli arsimor më i përfaqësuar në pyetësor. 26,53% e të anketuarve kanë përfunduar shkollën e mesme, e cila përfshin gjimnazin, shkollën artistike dhe shkollën profesionale. 22,45% e të anketuarve kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve, çka tregon se janë me diplomë Master. Ky grup përfaqëson individë që kanë ndjekur studimet pasuniversitare, duke theksuar një fokus në ndjekjet e avancuara akademike. 17.35% e të anketuarve kanë përfunduar arsimin bazë. Kjo kategori mund të përfshijë të anketuarit më të rinj. 2.04% e të anketuarve kanë përfunduar ciklin e tretë të studimeve, duke përfshirë program Doktoratur, Specializim ose Master Ekzekutiv, duke treguar një segment më të vogël të dedikuar kërkimit të avancuar ose studimeve të specializuara. Vetëm 1.02% e të anketuarve kanë përfunduar programe të studimit profesional të lartë. Gjithashtu, nga pergjigjet e te rinjve evidentohet se 71.4% e tyre nuk janë aktualisht të angazhuar/pjesë e një organizate rinore/për rininë dhe 28.6% e tyre janë.


### 4.1.NIVELI I INFORMIMIT MBI LIGJIN 75/2019 “PER RININE”

46, 94% e të anketuarve deklarojnë **se nuk kanë dëgjuar** për Ligjin 75/2019 “Për rininë”. Kjo tregon për një pjesë të konsiderueshme të të rinjve që mund të jenë më pak të angazhuar me përditësimet legjislative ose nuk janë arritur në mënyrë efektive nga fushatat ndërgjegjësuese.

43,88% e të anketuarve **kanë dëgjuar për ligjin** 75/2019 “Për rininë” ndërkohë që 9.18% e të anketuarve **janë të pasigurt**. Ka pothuajse një ndarje të barabartë mes atyre që janë shprehur se kanë degjuar rreth ligjit dhe dhe atyre që janë shprehur negativisht si dhe me një segment të vogël të pasigurt. Kjo nënvizon nevojën për iniciativa të vazhdueshme ndërgjegjësuese për të siguruar që të rinjtë janë të mirëinformuar për ndryshimet kryesore legjislative që mbrojnë interesat e tyre.

#### 6. A keni dëgjuar për Ligjin 75/2019 “PËR RININË”?

98 responses



Pasi u pyetën lidhur me dijeninë mbi ndryshimet specifike që parashikon ligji 75/2019 “Për rininë”, 46,84% e të anketuarve të kombinuar (ata që janë shumë mirë të informuar dhe ata që janë në dijeni në përgjithësi) kanë njëfarë niveli të ndërgjegjësimit për ndryshimet specifike të ligjit, një pjesë e konsiderueshme prej 43,04% **nuk kanë dijeni**. Kjo thekson rëndësinë e fushatave të mëtejshme

informuese për të siguruar që të rinjtë jo vetëm të dinë për ekzistencën e ligjit, por edhe për përmbajtjen dhe implikimet e tij.

Kur u pyetën për ekzistencën e një ministrie të përkushtuar në Shqipëri, përgjegjëse për rininë një masë e konsiderueshme 72.4% e të anketuarve konfirmuan se **janë në dijeni të** një ministrie të dedikuar në Shqipëri që është përgjegjëse për fushën e rinisë. Ndërsa 17.3% e të anketuarve **nuk janë në dijeni** për një ministri të tillë si dhe 10.2% e të anketuarve **janë të pasigurt** nëse ka një të tillë. Këto rezultate tregojnë për nevojën për komunikim më të zgjeruar ose përpjekje edukative për të informuar dhe angazhuar më tej të rinjtë rreth strukturave institucionale të krijuara për përfitimin e tyre.

Po ashtu, 74.5% **pajtohen me pohimin** se 'ekzistenca e një Ministrie të dedikuar për Rininë rrit vëmendjen kundrejt të rinjve në nivel institucional' ndërsa 18.4% e të anketuarve janë **neutralë** për këtë temë dhe vetëm 6.1% e të anketuarve **nuk pajtohen** me deklaratën.

Për sa i përket ndërgjegjësimit për ekzistencën dhe rolin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, 39.8% e të anketuarve shprehen pozitivisht dhe një përqindje e konsiderueshme (34.7%) e të anketuarve shprehen se **nuk janë në dijeni** dhe 19.4% e të anketuarve janë të vetëdijshëm për ekzistencën e agjencisë, por nuk kanë informacion të detajuar për rolin e saj.

Ndërkohë, 43,9% e të anketuarve e dinë se çfarë është Këshilli Kombëtar i Rinisë; 37.8% e të anketuarve nuk janë në dijeni të Këshillit Rinor Kombëtar dhe rreth 18.3% janë të pasigurt për

Të pyetur mbi njohurinë për ekzistencën e Strategjisë Kombëtare për Rininë, 39.8% e pohojnë. 31.6% e të anketuarve pranojnë **se nuk kanë informacion (nuk e dinë)** për ekzistencën e një Strategjie Kombëtare për Rininë, duke vënë në dukje një hendek të theksuar në ndërgjegjësim. 18.4% deklarojnë me siguri se nuk ka një dokument të tillë dhe 10.2 % % janë përgjigjur me **“nuk jam i sigurt”**, duke nënvizuar më tej pasigurinë në lidhje me strategjinë. Në thelb, ndërkohë që një segment i të anketuarve është i informuar për ekzistencën e një dokumenti të tillë, ka një pjesë të konsiderueshme që ose nuk ka informacion ose është i pasigurt ose ka informacion të gabuar duke menduar se ajo nuk ekziston.

Gjithsesi, 75.5% e të rinjve besojnë se **ekzistenca e një dokumenti strategjik kombëtar për rininë shërben për të adresuar më mirë problematikat rinore dhe për të gjetur zgjidhje konkrete**. Kjo tregon një konsensus të fortë midis të rinjve për rëndësinë dhe efektivitetin e një dokumenti strategjik kombëtar kushtuar çështjeve rinore. Vetëm 9.2% e të anketuarve janë të pasigurt për ndikimin ose rëndësinë e një dokumenti të tillë apo 9.2 % e tyre nuk pajtohen me deklaratën.


## 4.2. PERCEPTIMI MBI ZBATIMIN E LIGJIT 75/2019 “PER RININE” NË NIVEL VENDOR

Shumica e të anketuarve, 56.1%, **kanë dëgjuar** mbi **Këshillat Vendorë Rinorë** që synohen të ngrihen pranë bashkive. Por një përqindje po ashtu e konsiderueshme, 33.7% e të anketuarve, shprehen se **nuk kanë dëgjuar** për këto struktura dhe 10.2 % e tyre **nuk janë të sigurt**. Këto dy dhëna theksojnë nevojën për shtrirje informacioni dhe ndërgjegjësim i të rinjve mbi iniciativa rinore lokale që përfaqësojnë ata. Këtë e përforcon dhe fakti se 41.8 % e të rinjve deklarojnë se **nuk e dinë** nëse është ngritur Këshilli Vendor Rinor në Bashkinë ku jetojnë.

Gjithsesi është pozitiv fakti se shumica e tyre, rreth 64.3 % janë dakord me pohimin se **'ekzistenca e Këshillave Vendorë te Rinise pranë bashkive e përmirëson rolin dhe pozitën e të rinjve në nivel lokal'**

16. A jeni dakord me pohimin se 'ekzistenca e Këshillave Vendorë Rinorë pranë bashkive e përmirëson rolin dhe pozitën e të rinjve në nivel lokal'


98 responses



Informacioni i ulët lidhur me nisma/politika rinore që i prekin direkt ata në nivel lokal mbështëtet dhe nga fakti se 50% e të anketuarve nuk kanë informacion (nuk e dinë) nëse në bashkinë ku jetojnë **ka dokument strategjik për zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor**. Kjo nënvizon nevojën që bashkitë të rrisin përpjekjet e tyre për komunikim dhe të sigurojnë që dokumente të tilla strategjike të jenë të disponueshme dhe të mirëpublikuara. Përqindja e të rinjve që e dinë që ka punonjës në bashkinë ku jetojnë që mbulon çështjet e rinisë është më e lartë krahasuar me informacionin mbi dokumentin strategjik. 44.9% e të anketuarve janë **të vetëdijshëm** se bashkia e tyre e ka një punonjës të tillë që mbulon çështjet e të rinjve. Gjithsesi një segment tjetër i lartë po ashtu, 45.9 e të anketuarve **nuk janë në dijeni apo nuk janë të sigurt** mbi ekzistencën e personelit për çështjet rinore në bashki. Kjo përqindje e konsiderueshme tregon për boshllëqe të mundshme të komunikimit ose mungesën e dukshmërisë në lidhje me role të tilla në nivel lokal.

18. A ka në Bashkinë tuaj punonjës që mbulon çështjet për rininë?

98 responses





### 4.3. PERCEPTIMI I TË RINJVE MBI ROLIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË IMPLEMENTIMIN E LIGJIT TË RINISË

Pyetësi ka synuar të masë dhe perceptimin e të anketuarve në lidhje me rolin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në zbatimin efektiv të ligjit 75/2019 “Për të rinjtë”. Mbi gjysma, ose 53,1% e të anketuarve mendojnë se organizatat e shoqërisë civile kanë një ndikim pozitiv në zbatimin e ligjit 75/2019 “Për të rinjtë”. Kjo tregon se shumica e të rinjve e njohin dhe e vlerësojnë rolin e OSHC-ve në përkrahjen dhe avokimin e politikave me në qendër rininë. Kjo përforcohet dhe nga fakti se 69.4% **mendojnë se organizatat e shoqërisë civile duhet të luajnë një rol më aktiv në informimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre lidhur me zbatimin e Ligjit 75/2019 “Për Rininë”.**

Të rinjtë janë pyetur mbi zhvillimet e 3 viteve të fundit në sektorin e rinisë. 45.9% e të anketuarve mendojnë se zhvillimet në sektorin e rinisë gjatë tre viteve të fundit kanë përmirësuar situatën për të rinjtë. 23.5% e të anketuarve mendojnë se pavarësisht zhvillimeve, situata për të rinjtë mbetet e pandryshuar. Kjo mund të tregojë se ndërkohë që janë bërë përpjekje, ato nuk kanë qenë mjaft ndikuese për të sjellë ndryshime të dukshme në sytë e pothuajse një të katërtës së të anketuarve. 15.3% janë të pasigurt për ndikimin e zhvillimeve të fundit, duke theksuar një segment që mund të mos jetë i mirëinformuar ose i angazhuar sa duhet për të vlerësuar ndryshimet në sektorin e të rinjve. Një pjesë më e vogël, 8.2%, mendon se zhvillimet e fundit kanë qenë kundërproduktive, duke përkeqësuar situatën tek të rinjtë dhe 7.1% e të anketuarve nuk kanë asnjë mendim.

## PËRFUNDIME

Pyetësi 'Perceptimi i të Rinjve mbi Zbatimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë"' synoi të mase perceptimin e të rinjve mbi implementimin e ligjit. Ne te u perfshine 103 të anketuar ku 95 % e tyre janë 15-29 vjeç dhe jetojne ne 12 qarqet e Shqiperise. Disa nga perfundimet jane si me poshte:

- Ka nevojë për iniciativa të vazhdueshme ndërgjegjësuere për të siguruar që të rinjtë të risin nivelin e informimit mbi kuadrin ligjor dhe strategjik që mbron interesat e tyre, strukturave institucionale që i përfaqëson ata në nivel qendror dhe vendor.
- Parimisht ka konsensus të fortë midis të rinjve për rëndësinë dhe efektivitetin e dokumentave strategjik kombëtarë kushtuar çështjeve rinore.
- Shumica e të rinjve e njohin dhe e vlerësojnë rolin e OSHC-ve në përkrahjen dhe avokimin e politikave me në qendër rininë. ***Kjo përforcohet dhe nga fakti se 69.4% mendojnë se organizatat e shoqërisë civile duhet të luajnë një rol më aktiv në informimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre lidhur me zbatimin e Ligjit 75/2019 "Për Rininë".***
- Në ndryshim nga pyetësi i adresuar përfaqësuesve të OSHC-ve, ku janë dhënë komente dhe rekomandime për secilin nga institucionet, në pyetësin adresuar të rinjve, vihet re evitim i këtij sesioni. Është e kuptueshme që përfaqësuesit e organizatave rinore/për të rinjtë janë më të angazhuar dhe të interesuar në përmirësimin e kuadrin legjislativ/politik dhe institucional për sektorin e rinisë.

# BIBLIOGRAFIA

- AKR, 'Thirrja e dytë', <https://rinia.gov.al/thirrja-e-2te/>
- AKR, 'Thirrja e Tretë për Projekt propozime', <https://rinia.gov.al/thirrja-e-trete-per-projekt-propozime-organizatat-rinore-dhe-organizatat-per-te-rinjte/>
- AKR, 'Udhëzues për aplikantët –njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të thirrjes publike për projekt propozime (ii)' [https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/04/Udhezuesi-i-aplikimit\\_NJVV.pdf](https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/04/Udhezuesi-i-aplikimit_NJVV.pdf)
- AKR, 'Vlerësimet paraprake', <https://rinia.gov.al/ep-content/uploads/2023/08/vleresimet-paraprake.pdf>
- AKR, 'Pyetje të shpeshta mbi Thirrjen Publike Nr.I 'Për Projektpropozime, Drejtuar Organizatave Rinore dhe për të Rinjtë', <https://rinia.gov.al/ewp-content/uploads/2023/05/FAQ-OJF-Thirrja-2.pdf>
- Dafina Peci, Enxhi Lipa, Rigels Xhemollari, (2022) 'Implementimi i Ligjit për Rininë, Përceptimi i të Rinjve dhe OSHC-ve'+
- Kontrolli i Lartë i Shtetit, 'Raport Perfundimtar, Auditim Perputhshmerie per MSHRF dhe AKR', Janar 2023, faqe <https://rinia.gov.al/ewp-content/uploads/2023/12/Raport-auditimi-KLSH.pdf>
- Ligji nr. 75/2019 'Për rininë' neni 1/2/4
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ditari Mujor, Faqja Zyrtare, <https://Riniafemijet.Gov.AL/ewp-Content/Uploads/2023/04/Ditari-Mujor-Mars-2023.Pdf>
- MSHRF, 'Muzhaqi: 23 projekte fituese për fuqizimin e të rinjve', publikuar më: 29/09/2023, <https://riniafemijet.gov.al/muzhaqi-23-projekte-fituese-per-fuqizimin-e-te-rinjve-nenshkruam-marreveshjet-me-23-organizata-fituese-nga-thirrja-e-trete-e-agjencise-kombetare-te-rinise/>
- MSHRF, 'Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029', <https://riniafemijet.gov.al/ewp-content/uploads/2023/04/strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2029.pdf>
- Vendim i Këshillit të Ministrave -në nr. 274, datë 12.5.2021, 'Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë organizata kombëtare përfaqësuese rinore'
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 24.3.2023 'Për miratimin e strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024'
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 29.7.2022 'Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë.'
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 681, datë 2.9.2020 'Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të agjencisë kombëtare të rinisë. (AKR)'
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 692, Datë 26.10.2022 'Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit 2022–2029'.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.833, datë 24.12.2021 'Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore'.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.91, datë 9.2.2022, 'Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024'



KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG



KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR